

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK**



POLITIKA EKONOMIKE

(Ligjërata të autorizuara – Pjesa e dytë)

Prishtinë, 2016

POLITIKAT EKONOMIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN

ASPEKTET EKONOMIKE TË INTEGRIMEVE EKONOMIKE

Teoria e integritimeve ekonomike i referohet politikës diskriminatore të zvogëlimit ose heqjes së plotë të barrierave tregtare në mes shteteve që njëkohësisht kyçen në ndonjë lloj të integrimit. Në këtë rast shkalla e integritimeve ekonomike mund të lëvizë nga lidhjet më të dobëta në mes shteteve siç janë: Zonat preferenciale të tregtisë, Zonat e tregtisë së lirë, Unionet doganore, Tregjet e përbashkëta dhe Unionet ekonomike.

1. Tregtia preferenciale – llogaritet si formë më e ulët e integrimit d.t.th. se marrëveshja tregtare në mes shteteve dhe karakterizohet me aplikimin e normave më të ulëta doganore në mes shteteve anëtare që kanë nënshkruar këtë marrëveshje, në krahasim me normat që aplikohen për shtetet tjera joanëtare. Si shembull më reprezentativ i kësaj marrëveshje është Komonvelti Britanik i vitit 1932 të cilën përveç Britanisë së Madhe përfshinte edhe teritorët ish - koloniale britanike.

2. Zona e tregtisë së lirë – është formë e integrimit ekonomik në kuadër të cilës shtetet anëtare i heqin të gjitha barrierat tregtare (doganat dhe pengesat tjera tregtare) në tregtimin e tyre, por duke i ruajtur dhe mbajtur normat e mëparshme doganore, zakonisht për importe ndaj shteteve të tjera joanëtare. Në këtë formë të integrimit bënë pjesë Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (*European Free Trade Association-EFTA*) që ishte themeluar në vitin 1959 me iniciativë të Britanisë së Madhe dhe në themelimin e saj kishin marrë pjesë 7 shtete të Evropës Perendimore (Britania e Madhe, Austria, Zvicra, Danimarka, Norvegjia, Portugalia dhe Suedia). Kjo marrëveshje kishte hyrë në fuqi në vitin 1960, ndërsa më vonë të njëjtës i ishin bashkuar edhe Greqia, Finlanda, Islanda dhe Lihtenshtajni. Sot marrëveshja EFTA numëron vetëm katër shtete anëtare: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra, pasi që të gjitha shtetet e më parshme anëtare e kanë lëshuar EFTA-në pas antarësimit të tyre në BE.

CEFTA (Central European Free Trade Agreement) - Historia e themelimit të CEFTA-së daton që nga fillimi i viteve të '90 të shekullit të kaluar, pas shembjes së murit të Berlinit dhe prishjes së SEV-it (**KNER** – Këshillit për Ndihmë Ekonomike Reciproke) që ishte një integrim ekonomiko-tregtar në mes ish-shteteve komuniste.

Të gjitha shtetet e dala nga sistemi i planifikuar filluan me shpejtësi dhe suksese të ndryshme zbatimin e reformave të orientuara (tranzicionin ekonomik dhe politik), për të kaluar sa më shpejtë në sistemin e ekonomisë së tregut, me qëllim të plotësimit sa më të shpejtë të kriterëve të parashtruara politike dhe ekonomike. Pas prishjës së tregut të mëparshëm të KNER-it shumica e shteteve ish-socialiste u orientuan në tregjet e BE-së dhe e njëjta doli me propozim që shtetet që filluan tranzicionin të fillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok.

Marrëveshja e parë e CEFTA-së u nënshkrua në Krakovë (Poloni) në dhjetor të vitit 1992 (dhe hyri në fuqi në janar të vitit 1993) në mes të Polonisë, Hungarisë, Çekisë dhe Sllovakisë. Nëpërmjet kësaj marrëveshje këto shtete pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur më lehtë institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike të BE-së, duke forcuar në këtë mënyrë demokracinë dhe ekonominë e tyre të tregut. Koha e paraparë për liberalizimin e plotë tregtar në mes shteteve nënshkruese ishte tetë vite.

Në vitin 1995 ndryshojnë edhe kushtet për pranimin e shteteve të reja në kuadër të CEFTA-së, që kishin të bënin me: antarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë, marrjen e statusit të shtetit kandidat për BE, si dhe me nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale tregtare në mes të gjitha shteteve anëtare.

Sllovenia zyrtarisht iu bashkua CEFTA-së në vitin 1996, Rumania në 1997, Bullgaria në 1998, Kroacia në 2003 dhe Maqedonia në vitin 2006.

Pasi që me 1 Maj të vitit 2004 u bë zgjerimi më i madh i BE-së, ku u antarësuan dhe Slovenia, Hungaria, Çekia, Slovakia dhe Polonia (si dhe 5 shtete joanëtare të CEFTA-së), anëtare të saj mbeten vetëm 3 shtete: Rumunia, Bullgaria dhe Kroacia. Pasi që në vitin 2007 të gjitha shtetet e mëparshme të CEFTA-së kishin hyrë në BE dhe kishin dalë nga CEFTA, (përveç Kroacisë) u vendos që CEFTA të shtrihej në pjesën e Ballkanit të mbetur jashtë BE-së.

Në këtë kohë Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia kishin nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lire, në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Të gjitha këto marrëveshje të nënshkruara në mënyrë bilaterale në mes këtyre shteteve u zëvendësuan nga një marrëveshje e vetme multilaterale - CEFTA.

CEFTA është një marrëveshje e tregtisë së lirë në të cilën tani marrin pjesë shtatë shtete të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Moldavia.

CEFTA në këtë rast paraqitet vetem si një element i integritit ekonomik rajonal. Elemente po aq të rëndësishëm të këtij integrimi janë iniciativa në fushat e tjera si: Komuniteti i Enejisë, Zona e Përbashkët e Aviacionit, Memorandumi i Evropës Juglindore në fushën e Transportit, Iniciativa e Evropës Juglindore në fushën e Telekomunikacionit dhe Internetit, Kompakti i Investimeve, etj. Të gjitha këto iniciativa synojnë krijimin e një tregu të përbashkët rajonal që në një fazë të mëvonshme do të integrohet në tregun e përbashkët të BE-së.

Në fakt, CEFTA është një instrument i para-hyrjes (pre-accession) në BE për të gjitha shtetet anëtare. Çdo shtet ish-komunist që është antarësuar sot në BE, ka qenë më parë anëtar i CEFTA-së dhe poashtu edhe çdo shtet që është në procesin e antarësimit në BE, patjetër duhet të jetë edhe anëtar i CEFTA-së.

Qëllimet e CEFTA-së janë: harmonizimi i zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike, përmes zhvillimit të tregtisë së ndërsjellë, përshpejtimi i zhvillimit të aktiviteteve tregtare, rritja e standardit jetësor, sigurimi i shkallës më të lartë të punësimit, rritja e prodhimit dhe sigurimi i stabilitetit financiar.

Implikimet pozitive dhe negative të CEFTA-së janë:

- a) **Implikimet pozitive:** rritja e këmbimeve tregtare në mes shteteve anëtare, mbrojtja e përbashkët nga shtetet joanëtare, lehtësimi i segmentimit të tregut të Ballkanit Perendimor, tërheqja më e lehtë e investimeve të huaja direkte, rritja e stabilitetit ekonomik dhe politik në rajon;
- b) **Implikimet negative:** shtetet anëtare bëjnë gara për një pozicion sa më të mirë në raport me BE, tensionet politike dhe etnike, dallueshmëria në madhësinë e shtetit dhe nivelit të zhvillimit, si dhe në kushtet e ndryshme për tërheqjen e investimeve të huaja direkte;

Qëllimi parësor i të gjitha shteteve anëtare të BE-së është antarësimi sa më i shpejtë në BE, dhe kjo marrëveshje trajtohet si një marrëveshje me karakter të përkohshëm.


3. Unioni Doganor - në kuadër të këtij unioni përveç heqjes së tarifave doganore në mes shteteve nënshkruese të kësaj marrëveshje, përfshihet edhe harmonizimi i politikave të tyre tregtare në drejtim të zbatimit të normave të përbashkëta doganore ndaj shteteve të treta. Si shembull më i shpeshtë i Unionit Doganor është Bashkimi Ekonomik si dhe Bashkësia Ekonomike Evropiane (*European Economic Community-EEC*) që është themeluar në vitin 1957 me

nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Gjermanisë Perendimore, Francës, Italisë, Belgjikës, Holandës dhe Luksemburgut.

4. Tregu i Përbashkët – paraqitet si formë më e lartë e integritimit, ku përveç heqjes së doganave në tregtinë në mes shteteve anëtare dhe zbatimit të politikës së përbashkët doganore ndaj shteteve të treta, mundësohet dhe lëvizja e lirë e forcës punuese, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit (si faktor prodhues), si dhe politika e përbashkët e marrëdhënjeve ekonomike me shtetet joanëtare. BE nga fillimi i vitit 1993, duke i faleminderuar liberalizimit të plotë të lëvizjës së kapitalit dhe mekanizmit të koordinimit të politikës ekonomike dhe asaj monetare të shteteve anëtare, nga niveli i Unionit Doganor ka evoluar në treg të përbashkët.

POPULLSIA E BE-së NË KRAHASIM ME PJESËT TJERA TË BOTËS

POPULLSIA E SHPREHUR NË MILIONA




Karakteri specifik por edhe i dallueshëm i BE-së vjen nga fakti se, si formë e integritimit ekonomik, ai ka shkuar më përpara se të gjitha format e tjera në të shkuarën apo të tashmen. Në fillim bëhej fjalë vetëm për një treg të përbashkët. Vitet e para deri në vitin 1968, i'u kushtuan kryesisht realizimit të bashkimit doganor dhe vendosjes së politikave bujqësore të përbashkëta. Pas krizës ekonomike të viteve të '70 të shekullit të kaluar dhe njëfarë ngadalësimi në procesin e integritimit, një impuls i ri u dha nga viti 1986 me nënshkrimin e Aktit

Unik Evropian, që kishte për qëllim të hiqte deri në vitin 1992, të gjitha vështërsitë për këmbimet, duke krijuar në këtë mënyrë një treg të vetëm unik në mes shteteve anëtare. Përgjegjësia e rregullimit të këtij tregu të madh është kaluar në nivelin evropian, gjë që kërkonte zhvillimin e politikave të përbashkëta gjithnjë e më të shumta (politika e tregtisë së jashtme, politika e konkurrencës, politika bujqësore, e transporteve, energjisë, mbrojtjes së konsumatorëve, etj.). Në fusha të tjera, përgjegjësia mbetet në duart e shteteve kombëtare, duke sjellë vetëm një bashkërendim midis shteteve anëtare, fjala është për politikat makroekonomike, politikën e punësimit, të mbrojtjes sociale, të shkencës dhe zhvillimit të teknologjive të reja, të arsimit dhe kualifikimit, etj.

SIPËRFAQJA TOKËSORE E BE NË KRAHASIM ME PJESËT TJERA TË BOTËS

SIPËRFAQJA E SHPREHUR NË 1000 km²



Bashkërendimi i politikave ekonomike bëhet akoma më i nevojshëm midis shteteve që kanë të njëjten monedhë, duke qenë se vetë politika monetare ka kaluar si përgjegjësi e Bankës Qendrore Evropiane. Në instancën e fundit, dinamika e integritit evropian është e ndërtuar rreth projekteve dhe politikave ekonomike për të cilat shtetet anëtare pranonin të bashkonin kompetencat e tyre dhe të transferonin një pjesë të sovranitetit të tyre.

Negociatat për pranimin e shteteve të reja në BE i nënshtrohen një procesi kompleks, që mund të zgjasë shumë vite, gjatë së cilës periudhë shqyrtohen, kapitull pas kapitulli, mënyrat se si do të zbatohen rregullat komunitare.

BASHKIMI EVROPIAN

500 MILIONË BANOR — 28 SHTETE ANËTARE



5. Unioni ekonomik - paraqet formën më të lartë të integritimeve ekonomike e që mund të paraqitet në formë të plotë ose të pjesërishtme. Unioni jo i plotë ekonomik nënkupton marrëveshjen e shteteve, ku përveç tregut të përbashkët, pranohet dhe aplikohet harmonizimi i politikave fiskale, monetare, industriale, rajonale dhe fushave të tjera të politikave ekonomike. Për dallim nga unioni jo i plotë, unioni i plotë ekonomik nënkupton dhe pranimin e politikës së përbashkët monetare dhe politikës ekonomike unike, si dhe institucioneve mbinacionale siç janë Parlamenti dhe Qeveria me autorizime mbinacionale. Një nga shembujt më reprezentativ të këtij unioni ekonomik ishte Bashkësia e shteteve të Beneluxit që ishte krijuar menjëherë pas Luftës së dytë Botërore në mes të Belgjikës, Holandës Luksemburgut. Unioni i plotë ekonomik shpeshëherë paraqitet edhe si parakusht për konstituimin e Unionit Politik.

GDP-së së tërë BE-së. Për shkak të mjeteve të kufizuara, politikat shpërndarëse dhe rishpërndarëse të BE-së mbeten shumë të kufizuara dhe të orientuara kryesisht në politikat bujqësore dhe politikat rajonale.

KU PO E HARXHON BUXHETIN BE?



PERIUDHA E TRANZICIONIT DHE KOSOVA

Qëllimi kryesor i politikës ekonomike është që qytetarëve t'i ofrohet një standard sa më i lartë jetësor. Parakushti i parë për t'u realizuar ky qëllim parësor është që të realizohet shtimi i të ardhurave kombëtare por edhe shpërndarja sa më e drejtë e tyre. E ardhura kombëtare krijohet në prodhimtari, dhe logjikisht rrjedhë konstatimi se për rritjen e të ardhurave kombëtare nevojitet që të krijohet një sistem adekuat, por edhe të sigurohen masat dhe instrumentet për rritjen e prodhimit. Në kuadër të shkencës ekonomike ekziston edhe termi "**e ardhura potenciale**" çka paraqet të ardhurën maksimale që do të realizohej sikurse të gjithë faktorët prodhues (toka, puna, kapitali dhe teknologjia) do të shfrytëzoheshin në mënyrë të plotë dhe atë në prodhimtaritë më efikase.

Çdo ekonomi kombëtare përbëhet nga katër sektor: primar, sekondar, terciar dhe kuartar. Gjatë historisë, pjesëmarrja e këtyre sektorëve në krijimin e prodhimit të gjithëmbarshëm ka ndryshuar. Në një periudhë të gjatë të historisë njerëzore, pjesëmarrje dominante kishte sektori primar, produktet bujqësore dhe blegtorale.

Në fund të shekullit të XVIII fillon ngadal zhvillimi intenziv i industrisë, kryesisht në shtetet e Evropës Perendimore, kështu që deri në fund të viteve të '60 të shekullit të kaluar pjesëmarrje më të madhe në krijimin e të ardhurës së përgjithshme kishte industria përpunuese, që përfshihet në kuadër të sektorit sekondar. Revolucioni teknologjik i viteve të '60 të shekullit të kaluar ndikoj në zhvillimin dhe lulzimin e shpejtë të sektorit terciar, kështu që rëndësia e këtij sektori u rritë në krijimin e të ardhurave kombëtare. Pas paraqitjes së teknologjive të reja dhe revolucionit informatik gjithnjë e më shpejtë në shtetet e zhvilluara po avancon sektori kuartar, që në rradhë të parë po mbështetet në teknologjitë e ndryshme informative si dhe përdorimin e resursit të informacionit si një resurs shumë dinamik i zhvillimit. Përdorimi i këtij resursi të regjenerueshëm gjithnjë e më shumë po ndikon në zhvillimin gjithnjë e më të shpejtë të sektorëve terciar dhe kuartar, me ç'rast në shtetet e zhvilluara pjesëmarrja e këtyre dy sektorëve arrinë në mbi 2/3 e të ardhurave të gjithmbarshme. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e bujqësisë (sektorit primar) në shtetet më të zhvilluara sillet nga 3 deri në 5%, nderkaq të industrisë përpunuese (sektorit sekondar) rreth 20%.

Sot në shumicën e vendeve të zhvilluara industriale, pjesën më të madhe të vlerës së GDP-së, e krijojnë sektorët terciar dhe kuartar, por ende vlenë një rregull se pa zhvillimin e sektorit primar (sektori i bujqësisë) dhe sektorit sekondar (industria përpunuese), nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm edhe të sektorëve të tjerë në kuadër të ekonomisë kombëtare. Bujqësia si veprimtari ekonomike është e rëndësishme, për dy arsye: së pari, ushqimi është një produkt strategjik (ushqimi është energji për njerëzit, siç është edhe energjia ushqim për makinat), pa të cilën as që mund të paramendohet jeta normale e njerëzve. Arsyeja e dytë ka të bëjë me atë se natyra e çdo shoqërie i ofron një ambient falas për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, kështu që do të ishte e pakuptueshme si në aspektin ekonomik ashtu dhe atë politik, që të mos shfrytëzohen këto begati të ofruara. Toka është një nga resurset e rralla (të limituara), me ç'rast dhe na paraqitet renta (pagesa për shfrytëzimin e saj), dhe do të ishte plotësisht joracionale sikur e njejtat të mos shfrytëzohet në mënyrë sa më efikase. Në fund të fundit, asnjë shtet as që do t'i për afrohej vlerës së të **“ardhurës potenciale”** nëse nuk e shfrytëzon resursin e tokës në mënyrë racionale dhe efikase. Në bazë të prodhimtarisë primare bujqësore gjithnjë e më shumë po zhvillohet industria bujqësore, industria e makinave dhe paisjeve të tjera, industria kimike, etj., të cilat gjithnjë e më shumë po përdoren në prodhimtarinë bujqësore dhe industrinë e ushqimit.

Me rënien e komunizmit në fillim të viteve të '90 të shekullit të kaluar, historia njerëzore definitivisht (në shumicën e rasteve) i'u mbështet kapitalizmit liberal, si një model univerzal zhvillimor për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore. Në fakt ky ishte një formë e revolucionit konzervativ që paraqitej si një nevojë historike, për shumë kombe dhe që përmes fuqisë së *“dorës së padukshme”* të tregut të lirë do ti siguronte kombeve të tjera të botës: stabilitet, paqe dhe mirëqenie. Zhvillimi i këtyre shteteve në shumicën e rasteve ishte kuptuar si një privatizim i përgjithshëm (transformimi sa më i shpejtë i pronës shtetërore në atë private), liberalizim dhe derregullim i plotë i pjesës më të madhe të aktiviteteve ekonomike dhe financiare, duke pritur se shtimi i shpejtë ekonomik do të ndodhte vetëm si rezultat i automatizmit të tregut.

Neoliberalizmi si formë ekstreme e teorisë ekonomike neoklasike, ka filluar në fund të viteve të '70 të shekullit të kaluar, nga një grup i profesorëve të Universitetit të Çikagos. Në kuadër të këtij grupi dhe në bashkëpunim me Departamentin amerikan të financave dhe FMN-në e Bankën Botërore, në fund të viteve të '80 është lansuar një sistem i politikës i njohur si Marrëveshja e Washingtonit.

Autor i koncenzusit të Washingtonit është John Williamson dhe përmes këtyre rregullave është menduar që të zgjidhet kriza financiare në disa vende në Amerikës Latine dhe Afrikës.

Shumë shtete të Amerikës Latine dhe Afrikës e më pastaj dhe shumë shtete ish-komuniste i kanë pranuar këto politika të propozuara. Reformatorët në këto shtete, si dhe këshilltarët e tyre e përqaftuan dogmën neoklasike, se me kalimin e tyre në ekonominë e tregut, do të sjellë krizën e përkohshme, por pastaj shumë shpejtë ekonomitë e këtyre shteteve do të “shërohen”, përmes transformimit pronësor dhe privatizimit të pronës shtetërore.

Dhjetë “rregullat” e koncenzusit të Washingtonit kanë të bëjnë me:

1. Disiplinën fiskale;
2. Preorientimin e shpenzimeve publike;
3. Reformën tatimore;
4. Liberalizimin financiar;
5. Kurset e përbashkëta dhe konkurrues devizore;
6. Liberalizimin e tregtisë së jashtme;
7. Liberalizimin e investimeve të huaja direkte;

8. Privatizimin;
9. Derregullimin; dhe
10. Sigurimin e të drejtave pronësore.

Zbatimi i këtyre rregullave në shumë shtete të botës kishte dhënë efekte të pamjaftueshme e në disa ishte përkeqësuar edhe më tej situata ekonomike-financiare, që i shtyri hartuesit e këtyre rregullave që të njejtat t'i zgjerojnë edhe me 10 pika të reja, që shpeshherë theksohen si Koncenzusi plus i Washingtonit.

Dhjetë pikat e reja kanë të bëjnë me:

1. Menaxhmentin kooperativ;
2. Luftën kundër korrupsionit;
3. Fleksibilitetin e tregut të punës;
4. Antarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë;
5. Standardet financiare;
6. Liberalizimin e “kujdesshëm” të bilancit të kapitalit;
7. Kurset absolutisht fikse ose fleksibile devizore;
8. Bankën Qendrore të pavarur;
9. Sistemin e mbrojtjes sociale; dhe
10. Qëllimet e përcaktuara për zvogëlimin e varfërisë.

Kosova ka kaluar një rrugë shumë specifike të tranzicionit, nga fillimi i viteve të '90 të shekullit të kaluar e deri në vitin 1999, gjindej nën një okupim klasik kolonial, ndërsa në vitet e fundit të këtij okupimi baza e saj ekonomike thuajse plotësisht u shkatërrua, për shkak të plaçkitjeve dhe dëmeve të shkaktuara nga lufta. Pas vendosjes së Misionit të Përkohëshëm të KB-së (UNMIK), u fillua me procesin e tranzicionit, që ende është në vazhdim të sipër, e që për shkak të problemeve të trashiguara dhe mos ekzistimit të strategjisë adekuate, shpeshherë shihet si një “rrugëtim pa mbarim”. Përgjegjëse në kuadër të këtij misioni për zbatimin e procesit të tranzicionit (në fushën ekonomike dhe financiare) ishte shtylla e IV e UNMIK-ut që ishte nën kompetenca të plota të BE-së, e që në tërësi zbatoi konceptin neoliberal.

Kosova si dhe shumica e shteteve të tranzicionit pa hezitim e pranuan këtë koncept edhe pse plotësisht e papërgatitur, në krahasim me shtetet e zhvilluara por edhe në krahasim me disa shtete të rajonit. Përmes liberalizimit, shtetet më të zhvilluara, që posedonin një potencial shumë më të fuqishëm prodhës, kulturor e organizativ, paraprakisht siguruan një pozitë të privilegjuar në distribuimin e shtimit botëror dhe

pasurisë, ndërsa pasuria e tyre gjithnjë e më shumë po rritet, pasi që edhe këmbimi ndërkombëtar po zhvillohet sipas rregullave dhe interesave të tyre.

Pritjet për një zhvillim të shpejtë ekonomik, që do të reflektonte në ngritjen e shpejtë të mirëqenies shoqërore, në shumicën e shteteve të tranzicionit nuk ndodhi. Koncepti neoliberal në fund të fundit është një ideologji politike e shteteve të zhvilluara, e jo një doktrinë e mirëfilltë ekonomike. Pas "*dorës së padukshme*" tek shtetet e zhvilluara gjithëherë ekzistonë edhe roli "*i padukshëm*" i shtetit, që funksionon në periudhat e krizave, ndërsa në periudhat tjera vepron në mënyrë të padukshme, por fuqishëm në krijimin e kushteve për një zhvillim më të shpejtë dhe efikas, përmes krijimit të produkteve të reja, më efikase dhe më konkurrense në tregun global. Tregu si një institucion dhe mekanizëm nuk krijon produkte, ai është vetëm një hapsirë ku zhvillohet gara në mes produkteve të ndryshme, e që janë prodhuar në shtetet me shkallë të ndryshme të zhvillueshmërisë. Në instancën e fundit produktet prodhohen por dhe tregtohen në kuadër të një strukture (rrethi – ambienti), që organizohet nga ana e vet shtetit.

Edhe pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008, është vazhduar me zbatimin e konceptit të njejtë zhvillimor. Ky koncept për shkak të mungesës së njohurive dhe komoditetit të elitave ekzistuese politike, po zbatohet në bazë të një inercioni, e në disa rasteve dhe imponimeve, pavarësisht pasojave të shumta negative që po i shkaktohen shoqërisë kosovare.

Nga përvojat e disa shteteve të BE-së rezulton se transformimi më i shpejtë dhe efikas i shoqërisë së caktuar mund të mbështetet vetëm përmes ndikimit të shtetit në stimulimin e zhvillimit të sektorit primar (duke zhvilluar njëkohësisht dhe sektorin e industrisë ushqimore) dhe përmes zbatimit të strategjisë bashkëkohore të ri-industrializimit. Në zhvillimin e industrive bashkëkohore ndikohet përmes veprimit të politikave industriale.

Politika industriale, po ashtu përgjigjet edhe në tri dilema kryesore të shkencës ekonomike: Çka?, Si? dhe Për kë të prodhohet?, Çka të prodhohet është e përcaktuar nga resurset e disponueshme si dhe nga ato që mund të importohen me kushte optimale. Si të prodhohet, përcaktohet nga teknologjia prodhuese, niveli, shkalla dhe përgatitja arsimore, dhe mënyra e organizimit të prodhimit. Për kë të prodhohet përcaktohet nga struktura e tregut kombëtar ose atij global.

Politika industriale përdor kombinimin e masave të ndryshme si dhe politika të ndryshme si: politika fiskale, tregtare, teknologjike dhe arsimore, të të ardhurës,

mbrojtjen e ambientit jetësor, e politika të tjera. Po ashtu për të realizuar efekte të pritura, nga politika industriale duhet që të harminizohet dhe organizimi i administratës shtetërore, respektivisht sektori publik. Shtytja më e mirë për zbatimin e politikës industriale, gjindet në infrastrukturën institucionale të enteve dhe instituteve të specializuara, agjencioneve të specializuara si dhe parqeve teknologjike dhe inovative, në kuadër të së cilave mund të përmirësohen produktet ekzistuese ose të krijohen produkte të reja, por dhe veprimtari të reja inovative.

Republika e Kosovës gjatë tërë këtyre viteve nuk kishte Strategji të Zhvillimit (në vitin 2003 ishte përgaditur një strategji zhvillimore, nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por e njejta nuk u zbatua për arsye të ndryshme). Për herë të parë Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2016 ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021 (SKZH).

| Krahasimi i pesë treguesve të përzgjedhur Treguesi | Kosova | Mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së |
|---|---------------|---|
| Bruto produkti vendor për kokë banori | €2,935 | €3,504 |
| Përqindja e papunësisë | 30,1% | 20,8% |
| Pjesëmarrja në tregun e punës | 40,5% | 49,7% |
| Përqindja e popullsisë që jetojnë në varfëri | 29,9% | 19,7% |
| Mbulimi i importeve me eksporte | 12% | 46,5% |

Aprovimi i Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021 (SKZH), ka për pikënisje faktin se një prej pengesave kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës është vetë koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale, të identifikuara nga studime të ndryshme si të institucioneve vendore ashtu edhe atyre ndërkombëtare.

Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021 është në harmoni të plotë me proceset e tjera strategjike, sikurse është procesi i integritimit në BE përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) apo Programit për Reforma Ekonomike (PRE), pasi që masat e parapara në SKZH janë kryesisht të

sinkronizuara dhe të koordinuara me prioritetet e reformave ekonomike dhe institucionale të nevojshme për integrimin sa më të shpejtë të Kosovës në BE.

Përzgjedhja e prioriteteve zhvillimore dhe masave të propozuara në Strategji është bërë duke u bazuar në dy parime të përgjithshme. Parimi i parë, ka të bëjë me sigurimin e normave vjetore më të larta të rritjes ekonomike. Kjo nënkupton nevojën për rritjen e të ardhurave, e për rrjedhojë edhe të punësimit më të përshpejtuar, si dhe ngritjes së mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Parimi i dytë është nevoja që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe kohezioni shoqëror dhe gjithëpërfshirje, gjë që nënkupton mospërfshitim të grupeve të caktuara të shoqërisë nga përfitimet e rritjes së pritshme ekonomike. Gjithëpërfshirja është e domosdoshme jo vetëm për shkak se është parakusht për drejtësi shoqërore dhe kohezion, por edhe për shkak se si e tillë ajo mundëson rritje më të madhe dhe më të qëndrueshme ekonomike.

Strukturalisht, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021 është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese, si dhe zhvillimi i infrastrukturës. Këto shtylla bëjnë që kjo të jetë një strategji **që premtion Punë, Ligj, Afarizëm dhe Ndërtim (PLAN)**.

Kosova sot **qëndron më keq se shtetit e rajonit sa i përket aftësive të fuqisë punëtore**. Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, (mbi 32% sipas të dhënave të AKS), paradoksi tjetër është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë punëtorë të shkathët dhe profesione të kërkuara. Një ndër shkaqet kryesore qëndron te sistemi i arsimit, që viteve të fundit nuk po është fleksibil me kërkesat e tregut të punës. Problem tjetër gjithashtu përbën mungesa e përputhshmërisë së aftësive dhe shkathtësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, teksa mungojnë lidhjet në trekëndëshin ndërmjet shkollave, bizneseve dhe komuniteteve.

Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë janë çështje të rëndësishme jo vetëm për shkak se sigurojnë drejtësi shoqërore, por se siguria juridike dhe efektiviteti i institucioneve është parakusht që në një vend të mund të ketë mirëqenie të mirëfillët ekonomike. Ndërtimi i një shoqërie të bazuar në ekonomi të tregut, kërkon besim në drejtësinë dhe paanshmërinë e institucioneve, si dhe efektivitetin e tyre në kryerjen e shërbimeve. Pakkush dëshiron të jetojë, e lëre më të investoj para në një vend ku shteti nuk është paralelisht edhe mbrojtës i interesit publik, edhe mbrojtës i ndërmarrësisë së lirë, sepse vetëm kështu mund të krijohet konkurrencë e ndershme dhe mjedis i përshtatshëm për të zhvilluar bizneset.

Pasiguria juridike e shtyp dhe e destimulon shpirtin e ndërmarrësisë, dekurajon investimet, si ato vendore ashtu edhe investimet e huaja direkte dhe shkakton pabarazi në një treg të hapur dhe konkurrues duke rezultuar në zvogëlim të rritjes ekonomike në njërin anë, dhe në rritjen e paknaqësive sociale për shkak të shpërndarjes jo të barabartë të së ardhurës së krijuar, në anën tjetër.

Për këto arsye, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, synon që të rrisë përkrahjen e shtetit për procesin e ri-industrializimit në Kosovë, në mënyrë që ndërmarrjet private dhe ato publike të mund të rriten dhe të kalojnë në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë dhe të prodhojnë mallra të tregtueshme apo shërbime të konkurrueshme për eksport në tregjet e huaja. Ky qëllim nuk mund të realizohet, në rast se nuk ndërmerren masat adekuate dhe të përdoren instrumentet, që do të mundësojnë krijimin e lehtësirave dhe ofrimin e stimujve për investitorët strategjik dhe për projekte dhe nisma që e rrisin konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, sidomos për arritjen e standardeve të cilësisë për eksport dhe për tregun vendor.

Për këto arsye, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, synon që t'i orientojë resurset financiare të shtetit drejt ndërtimit të aseteve strategjike të infrastrukturës të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit. Në sektorin e energjisë, çështja e sigurisë së furnizimit do të adresohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja të bazuara në linjit, ndërkohë që do të shqyrtohen mundësitë për përdorimin e burimeve të ripërtërishme nga uji, era dhe biogasi.

Qasja në burimet natyrore është një ndër faktorët kryesorë për sjelljen e investimeve të huaja direkte (IHD). Zhvillimi dhe hulumtimi i minierave ekzistuese në Kosovë dhe hapja e atyre të reja është një mundësi për të rritur punësimin dhe standardet e jetesës, për të mundësuar krijimin e industrive dhe për të rritur GDP dhe eksportet, me të vetmin qëllim që në vitet e ardhshme, deficit në bilancin e tregtisë së jashtme të ekuilibrohet (momentalisht ky deficit në vitet e fundit çdo vit është më i lartë se 2 miliardë Euro).

Kjo është dhe arsyeja se pse as pas pavarësisë ende nuk e kemi krijuar bërthamën e ekonomisë kombëtare, kur dihet se të gjitha shtete e zhvilluara dhe disa të rajonit e kanë hartuar dhe janë duke e implementuar të njejtën strategji të zhvillimit industrial.

Nuk mund të pritët që industria kosovare do të ketë një gamë të gjërë të produkteve që do t'i prodhoj, dhe për këtë arsyeje në kuadër të politikës industriale duhet që të përcaktohen, kahjet dhe standardet, si dhe krijimin e institucioneve mbështetëse që

do të lehtësonin realizimin e projekteve më parë të përcaktuara. Arsyeja parësore se pse më parë duhet të ndërmerren këto veprime, kanë të bëjnë me procesin e globalizimit, që gjithnjë e më shumë po e forcon lojën e konkurrencës, me gjithnjë e më shumë lojtar (prodhues). Në kuadër të tregut global nuk konkurojnë vetëm produktet e caktuara, shërbimet apo firmat, por dhe industritë e ndryshme, rajonet, shtetet, integrimet ekonomike e kontinentet. Në këtë rast çdo ekonomi kombëtare organizohet në kuadër të hapsirës së saj, me të vetmin qëllim që të jetë sa më e suksesshme dhe konkurruese në tregun global.

Republika e Kosovës është vend i vogël (me gjithsejtë 10.908 km² dhe 1,8 milionë banorë) dhe pjesëmarrja e saj në krijimin e GDP-së botërore apo edhe të Bashkimit Evropian është simbolik (në ate botëror vetëm 0,0000317%, ndërsa në ate të BE-së me 0,00356%). Përdorimi i vetëm resurseve natyrore dhe remitencave në të ardhmën nuk mund që të sigurojë standard të kënaqshëm jetësor e as rritjen e pritur të mirëqenies shoqërore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Përparësitë komparative si një bazament i përparësive konkurruese në tregun global është e mundur të fitohen vetëm për disa prodhime (produkte). Këto përparësi komparative në kushtet e globalizimit gjithnjë e më të shpejtë, mund të arrihen përmes arsimimit më cilësor, teknologjive të avancuara si dhe përcaktimit të qartë të qëllimeve në kuadër të strategjive adekuate, se çka, si dhe për kë do të prodhohet në dekadat e ardhshme.

Me politikën industriale ngushtë është e ndërlidhur edhe politika e zhvillimit rajonal, pasi që çdo veprimtari zhvillohet ose do të zhvillohet, në një pjesë të shtetit, ose në një rajon të caktuar. Për tu realizuar në mënyrë të duhur këto veprimtari ekonomike është më së e nevojshme që të ndërtohet infrastruktura e nevojshme fizike dhe ajo institucionale. Në këto raste ndërtimi i infrastrukturës sociale rritë në masë të madhe cilësinë e jetës e njëkohësisht edhe cilësinë e kapitalit njerëzor (human). Përmes politikës së zhvillimit rajonal mundësohet dhe krijohen parakushtet për ndërtimin e infrastrukturës ekonomike dhe sociale por dhe të asaj fizike dhe institucionale, dhe me anë të së njejtës jipet përgjigja në atë se ku do të prodhohet dhe se ku do të jetohet.


INTEGRIMI, BUXHETI DHE POLITIKAT EKONOMIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Deri në çfarë mase teoria ekonomike na ndihmon që të kuptojmë ndërhyrjen publike evropiane?

Struktura e buxhetit deri në “Akhenda 2000” dhe debatet aktuale lidhur me reformat buxhetore dhe zgjerimin me vende të reja.

Historikisht, politika nuk i paraprin ekonomisë por ishte ndërtimi ekonomik ai që mundësoi zhvillimin e një sovraniteti mbikombëtar.





























GDP e BE-së NË KRAHASIM ME PJESET TJERA TË BOTËS



Realiteti i Bashkimit Evropian është më kompleks dhe që është produkt i një ndërtimi të dalë nga një përballje, kompromis dhe përshtatje, më tepër se rezultat i një procesi racional.

Përgjegjësia e BE-së ka të bëjë jo vetëm me sigurimin e një kuadri të favorshëm duke garantuar stabilitetin e çmimeve, konkurrencën dhe një minimum rregullash sociale dhe mjedisore të përbashkëta.

Tabela 1. Zgjerimi i BEE/ BE

| VITI | SHTETI |
|------|---|
| 1957 | Franca  Gjermania  Italia  Holanda  Belgjika  Luksemburgu  |
| 1972 | Britania e Madhe  Danimarka  Irlanda  |
| 1981 | Greqia  |
| 1986 | Spanja  Portugalia  |
| 1995 | Finlanda  Austria  Suedia  |
| 2004 | Slovenia  Slovakia  Çekia  Polonia   Litvania  Letonia  Estonia  Hungaria  Malta *  Qipro  |
| 2007 | Bullgaria  Rumunia  |
| 2013 | Kroacia |

Buxheti në parim është simbol i një kontinuiteti solidar, që nëpërmjet mbledhjes së kuotave kolektive, realizon shpenzime nga të cilat përfitojnë të gjithë. Por niveli i ulët i buxhetit evropian (vetëm 1,08 % e GDP-së në vitin 2006) është 20 herë më pakë se buxheti federal i SHBA-së, tregon dobësimin e komunitetit evropian, ose faktin që ky i fundit është kryesisht rezultat i një bashkëpunimi midis shteteve anëtare.

Që nga viti 1988 buxheti i BE-së, bën pjesë në një kuadër financiar shumvjeçar të quajtur “*persektiva financiare*”, që vendos për shpenzimet dhe hyrjet financiare të BE-së.

Votimi i buxhetit kalon nëpër një mekanizëm kompleks i cili përfshinë: Këshillin e BE-së (ish-Këshillin e ministrave) dhe Parlamentin, roli i të cilit është rritur edhe më tej. Hyrjet votohen paraprakisht nga Këshilli mbi bazën e kuotave të vendosura në mënyrë kolektive nga ana e shteteve anëtare.

Për sa i përket shpenzimeve, përgaditet një para-projekt nga Parlamenti e pastaj diskutohet dhe në rast nevojë i njejt propozim ndryshohet nga ana e Këshillit.

Pas leximit të parë, Parlamenti mund të propozojë ndryshimin e shpenzimeve të detyrueshme dhe voton me shumicë absolute amandamentet që kanë të bëjnë me shpenzimet jo të detyrueshme. Në rast të bllokimit, buxheti i kthehet Parlamentit për një lexim të dytë dhe pas çbllokimit, Parlamenti ka fjalën e fundit me shumicën e anëtarëve dhe më 3/5 e votave.

Buxheti i BE-së nuk mund të jetë në deficit, të gjitha shpenzimet duhet të mbulohen nga të hyrat vjetore dhe që nga viti 1999, nuk duhet të kalojë pragun prej 1,27% të GDP-së së Bashkimit Evropian.

HYRJET E BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM

Bashkimi Evropian financohet nga katër kategori kryesore burimesh:

- a) Taksat dhe doganat që vijnë nga tarifa e jashtme e përbashkët, ndërsa nga viti 1992 Këshilli unifikoi të gjithë tekstin në lidhje me regularizimin doganor;
- b) Kuotat bujqësore janë taksa diferencuese mbi importin e produkteve bujqësore të cilat preken nga organizimet e tregut dhe çmimi i tyre është më i ulët se i BE-së. Në përgjithësi këto taksa përfaqësojnë diferencën midis “çmimit prag” dhe çmimit të produktit të importuar. Duhet të theksohet se këto dy burimet e para, kuotat e vendeve anëtare për llogarinë e BE-së, përkonin me 29,1%, të totalit të vitit 1988, kure në vitin 2006 vetëm me 13%. E njëjta mund të shpjegohet nga liberalizimi i këmbimeve ndërkombatare dhe zvogëlimi në tërësi i taksave doganore në botë, nën ndikimin e GATT-it dhe më pas të OBT-së;
- c) Burimi i TVSH-së (tatimi mbi vlerën e shtuar), përkon me një përqindje uniform që prekë shportën TVSH të çdo ekonomie që është harmonizuar, duke patur parasysh faktin që vende të ndryshme nuk zbatojnë të njëjten përqindje. Ky burim përfaqëson rreth 14% të totalit të të hyrave në vitin 2006;
- d) Burimi e Ardhura Kombëtare Bruto llogaritet duke u nisur nga pjesa e çdo anëtari në të Ardhurën Kombëtare Bruto komunitare. Ky burim përfaqëson 72% të të hyrave totale në vitin 2006 dhe është rritur ndjeshëm viteve të fundit.

Tabela. Struktura e të hyrave të Buxhetit të BE-së për vitin 2011

| Përshkrimi | Buxheti 2011. |
|--|------------------------|
| Të hyrat tjera | 1,421,368,232 |
| Suficiti nga viti i kaluar fiskal | 4,539,394,283 |
| Teprica e mjeteve vetanake për shkak të pagesës së Fontit Garantues për akcione të | |
| Barazpeshimi i mjeteve vetanake nga TVSH dhe kontributet e shteteve anëtare nga vitet e mëparshme | |
| Tërë mjetet nga zërat 3 deri 9 | 5,960,762,515 |
| Neto shuma e burimeve tradicionale | 16,777,100,000 |
| Të hyrat nga TVSH-ja | 13,786,799,525 |
| Mjetet nga burimi i katërt | 90,022,018,370 |
| Ndarjet për të mbuluar burimet vetanake që kanë të bëjnë me nenin 2 të Vendimit 2007/436/EC Euroatom | 120,585,917,895 |
| Të gjitha të hyrat | 126,546,680,410 |

Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/budget/data/DB2012/EN/GenRev.pdf>

SHPENZIMET E BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM

Bashkimi Evropian, përveç shpenzimeve administrative që përbëjnë rreth 6% të të gjithë buxhetit, pjesën tjetër të buxhetit e shpenzon për zhvillimin dhe avancimin e konkurrencës komunitare, nëpërmjet arsimit, kërkimit dhe energjisë. Një pjesë tjetër ka për qëllim përmirësimin e shëndetit, të lirive, të qytetarisë, dhe së fundi marrëdhëniet me pjesën tjetër të botës me dhënien e subvencioneve. Por dy zërat më të mëdhenj të shpenzimeve, që prej disa vitesh, janë mbrojtja e drejtëpërsëdrejtë ose e tërthortë e bujqësisë dhe përpjekjet për të përforcuar kohezionin ekonomik në mes vendeve të ndryshme dhe rajoneve të BE-së. Realizimi i këtyre dy qëllimeve marrin pjesë që disa vite rreth 80% të totalit të shpenzimeve të BE-së. Po ashtu, jashtë buxhetit të përgjithshëm, shtetet e

ndryshme financojnë drejtëpërsëdrejti lloje të tjera akcionesh komunitare, siç janë: fondet evropiane të zhvillimit, shpenzimet e politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, dhe bashkëpunimit policor dhe gjyqësor.

Tabela . Struktura e shpenzimeve të BE-së për vitin 2011

| Emërtimi | Në miliardë Euro | % e buxhetit total |
|--|-------------------------|---------------------------|
| 1. Zhvillimi i qëndrueshëm | 53,892 | 43% |
| 2. Mbrojtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore | 56,038 | 44% |
| 3. Liria, siguria dhe drejtësia | 1,728 | 1% |
| 4. BE si lojtar global | 6,921 | 6 % |
| 5. Administrata | 7,918 | 6% |
| Shuma totale e shpenzimeve | 126,497 | 100 |
| Gjithsejt % nga GDP e 27 shteteve | 1,23 | |

Burimi: <http://eur-lex.europa.eu/budget/data/DB2012/EN/GenRev.pdf>

FONDET E NDRYSHME TË BE QË LEHTËSOJNË KONVERGJENCËN

Edhe pse të gjitha politikat e ndërmarra nga BE, përforcojnë pak a shumë kohezionin në mes vendeve, në mënyrë të drejtëpërdrejt ndikojnë fondet e kohezionit dhe fondet strukturale.

Fondet strukturale të “Axfenda 2000” kanë për qëllim realizimin e tre objektivave. I pari dhe i treti janë eskuziv për njëri-tjetrin për të njëjten zonë.

- a) Zhvillimi dhe vendosja strukturale në nivel të zonave që janë të prapambetura; niveli i tyre i jetesës duhet të jetë deri në 75% më i ulët se mesatarja e BE-së (Shpenzime që përbëjnë më shumë se 2/3 e buxhetit);
- b) Rikonvertimi ekonomik dhe social i zonave me vështërsi strukturore;
- c) Përshtatja dhe modernizimi i politikave dhe sistemeve kombëtare të arsimit, të formimit dhe punësimit (objektivë që nuk është rajonalizuar), financim i të cilit bazohet vetëm nga Fondet Sociale Evropiane.

Fondet strukturale të BE-së janë të ndara në pesë grupe:

- 1) Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (FEZhR) i krijuar në vitin 1975, ndihmon në zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara duke lehtësuar vendosjen në nivel struktural, sidomos përmes bashkëfinancimit të infrastrukturës ose investimeve të ndryshme;
- 2) Fondi Special Evropian (FSE), ka për mission që të përmirësoj mundësitë e punësimit, veçanërisht në zonat e prapambetura;
- 3) Fondi Evropian i Orientimit dhe i Garancisë Bujqësore, i themeluar në vitin 1962, merrë pjesë në bashkëfinancimin e regjimeve kombëtare të ndihmës për bujqësi dhe lehtëson zhvillimin dhe diversifikimin ekonomik të zonave rurale;
- 4) Instrumenti financiar i orientimit të peshkimit, që funksionon që prej vitit 1993, mbështet industrinë e peshkimit për t'u përshtatur me politikat komunitare;
- 5) Fondet e përshtatjës me globalizimin, i krijuar në vitin 2007, ka për qëllim që të ndihmojë punonjësit evropian që humbasin vendit e tyre të punës për shkak të përhapjës së këtij fenomeni.

Fondi i kohezionit është krijuar në vitin 1994 dhe i ndihmon financiarisht vendet dhe rajonet e BE-së, GDP-ja e të cilave është më e ulët se 90% e mesatares komunitare, për të realizuar ndërhyrje në mjedis dhe në transporte. Por, për të përfituar ende këto fonde, shtetet duhet të plotësojnë kriteret e konvergencës që kufizojnë deficitin buxhetor Brenda BE-së.

ÇFARË BUXHETI I DUHET NJË EVROPE TË ZGJERUAR

Diferencat në rritje, në të ardhura dhe në punësim, janë thelluar edhe më shumë me hyrjen e shteteve të reja anëtare. Në fakt, GDP-ja mesatare për banorë e 10 shteteve të reja të anëtarësuar në vitin 2004, është më e ulët se gjysma e mesatares së BE-së, kur e njejta kishte 15 shtete anëtare. Nëse antarësimi i 10 vendeve të reja e rrit me 2/3 numrin e anëtarëve të BE-së, popullsia e BE-së rritet me vetëm 20% (nga 380 në 455 milionë), sipërfaqja e BE-së me vetëm 19%, ndërsa GDP është rritur vetëm me 5%. Ekonomikisht, ky zgjerim ka të bëjë me masat që janë të dobëta, por shkakton shumë probleme për buxhetin evropian sepse rritet ndjeshëm numri i rajoneve që kanë të drejtë të përfitojnë nga fondet e kohezionit dhe sepse në vendet e reja, numri i personave që punojnë në bujqësi është mesatarisht tri herë më i lartë se mesatarja e BE-15.

Evropa duhet t'u bëjë ballë dy sfidave të mëdha:

- a) Rritja e diferencave në mes rajoneve për shkak të zgjerimit, dhe
- b) Ngadalësimi i rritjes ekonomike.

Për këtë qëllim, do të ishte e nevojshme që gjysma e shpenzimeve të shkonin për rritjen, duke patur si prioritet arsimin e lartë, edukimin dhe kërkimin, 30% do të shkonin për konvergjencën në mes rajoneve e vendeve, dhe 20% që do të ngelëshin do të shkonin për ristrukturimin, sidomos të sektorit bujqësor.
























Shumica e ekonomistëve dhe vendimarrësve politik mendojnë se rritja afatgjate mund të mbështetet vetëm mbi faktorët strukturorë (popullsia aktive dhe kapitali njerëzor, zotërimi i progresit teknik, dinamika e tregjeve, etj.) dhe se politika makroekonomike ka një rol të kufizuar vetëm në ruajtjen e stabilitetit në periudha afatshkurte dhe afatmesme. Për më tepër konstatohet se politikat makroekonomike të BE-së janë gjithnjë e më pak aktive dhe mjaftohen vetëm me vendosjen e rregullave të sjelljes së mirë për institucionet. Në të kundërtën, do të tregohet se politikat makroekonomike, veçanarisht politikat buxhetore mund të luajnë një rol themelor për të lehtësuar transformimet strukturore dhe për të dinamizuar rritjen.

Zgjedhja buxhetore kalon nëpërmjet politikave shtetërore. Një ekonomi që ballafaqohet me probleme specifike mund të përdorë përkohësisht një tepricë të shpenzimeve kolektive për të kufizuar kostot e shkaktuara dhe për të financuar zgjidhje të përshtatshme. Kjo supozon se shtetet e BE-së e kanë këtë mundësi. Pakti i Stabilitetit dhe rritjes, i vendosur në vitin 1997 me Traktatin e Amsterdimit, e kufizon shumë fushën e tyre të veprimit duke vendosur një prag prej 3% të GDP për deficitin publik dhe 60% për borxhin publik, por edhe duke detyruar shtetet anëtare të paraqesin çdo vit një “program afatmesëm stabiliteti” i cili duhet të përmbajë parashikimet e evolucionit të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore. Në rast të mos respektimit të Paktit, Këshilli mund të vendosë sanksione në formën e një depozite të papaguar pranë Bankës Qendrore Evropiane, ose me një gjobë që mund të sillt rreth 0,2-0,6% të GDP-së. Këto rregulla, të ndryshuara që prej marsit të vitit 2005, u vendosën për të shmangur sjelljet egoiste që do të qonin në një “mbyetje në borxhe” dhe herët apo vonë do të detyronin BQE-në, që kundër parimeve të saj, të monetizoj financimin e borxhit.

Nënkuptohej se vendet e ndryshme të BE-së nuk kanë interesa të njëjta dhe nuk mbrojnë të njëjtat konceptime të politikës ekonomike. Disa prej këtyre shteteve, zakonisht shtetet më të vogla, synojnë një lehtësim të kostove, veçanarisht në fushën e politikave të punësimit dhe fiskale dhe janë për një zbatim strikt të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes; kurse disa shtete të tjera sidomos pas vështërsive që kaloj Pakti, do të donin që të rivlersohej pesha e politikave buxhetore për të shoqëruar rritjen ekonomike.

Nga ana tjetër, qëndrimi i politikave amerikane, të cilat përdorin një politikë ekonomike që plotësisht mbështet kërkesën agregate, rritjen dhe punësimin, është krejtësisht e kundërt me politikat ekonomike që i mbështesin institucionet evropiane. Disa mendojnë se politika ekonomike evropiane mund të kalojë drejtëpërsëdrejti nga buxheti komunitar. Për këtë do të duhej që të rritej pesha e këtij buxheti dhe të bëhej autonom duke vendosur një taksë evropiane të veçantë nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, të ripërcaktohen fushat e konkurrencës së BE-së për t'i mbështetur mbi baza më të forta delegimet e pushtetit.

Tabela: Kontributi i shteteve anëtare (në %)

| Shteti | % | Shteti | % |
|---|-------|---|-------|
|  Belgjika | 3,53 |  Luksemburgu | 0,27 |
|  Bullgaria | 0,14 |  Hungaria | 0,55 |
|  Republika Ceke | 0,51 |  Malta | 0,03 |
|  Danimarka | 2,00 |  Holanda | 4,85 |
|  Gjermania | 20,50 |  Austria | 2,41 |
|  Estonia | 0,05 |  Polonia | 1,30 |
|  Greqia | 1,47 |  Portugalia | 1,15 |
|  Spanja | 7,85 |  Rumunia | 0,37 |
|  Franca | 19,55 |  Slovenia | 0,18 |
|  Irlanda | 0,91 |  Slovakia | 0,21 |
|  Italia | 12,86 |  Finlanda | 1,47 |
|  Qipro | 0,09 |  Suedia | 2,74 |
|  Latvia | 0,07 |  Britania e Madhe | 14,82 |
|  Litvania | 0,12 | | |

Burimi: European Council: *Financial Perspective 2007-2013*, Brussels

Së fundmi Parlamenti Evropian ka dhënë pëlqimin për buxhetin afatgjatë të BE-së për periudhën 2014-2020. Kufizimet buxhetore të buxhetit që kap shumën e 960 miliardë euro parasheh kufizime në shpenzimet evropiane, konsumi real është zvogëluar për 3,5% ose 35 miliardë dhe në veçanti përfshinë rajonet e varfëra, ose në kuptimin politik fushën e kohezionit, ndërsa nuk ka patur kufizime për fushën e hulumtimeve, ndihmës humanitare dhe kontrollave kufitare. Buxheti i quajtur korniza afatgjate financiare, është aprovuar me 537 vota pro dhe 126 vota kundër, pjesa më e madhe e votave kundër vinin nga rradhët e euroskeptikëve, bllokut të majtë evropian dhe nga të gjelbërtit.

Po ashtu, pagat dhe penzionet për personelin e BE-së janë ngrirë në nivel të vitit 2011, pasi që Gjykata Evropiane nuk ka gjet arsye për ndryshimin e këtij vendimi.

Në aktgjykimin e Gjykatës Evropiane është përkrahur qëndrimi i shumicës së vendeve të BE-së që kanë propozuar këto shkurtime, pasi që edhe të njëjtat kanë aplikuar masa të kursimeve edhe për administratat e këtyre shteteve.

Në këtë vit, Komisioni Evropian ka propozuar draft projektin për Buxhetin e BE-së, për vitin 2016 që kap shumën prej 143,5 miliardë euro, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë evropiane. Këto mjete do të investohen me qëllim të stimulimit të inovacioneve, hapjes së vendeve të reja të punës, përafrimit të nivelit të zhvillimit të shteteve dhe rajoneve të caktuara me mesatarën e BE-së, si dhe forcimin e rolit të BE-së në skenën globale. Propozimi i buxhetit përfshinë dhe kontributet për Fondin Evropian për Investime Strategjike, që është pika kryesore e planit investiv të komesarit Junker.

Sipas propozimit parashihet se rreth 67 miliardë euro do të përdoren për stimulimin e zhvillimit ekonomik, punësimit dhe konkurrencës, ndërsa 43 miliardë euro do të përdoren në sektorin e bujqësisë.

POLITIKAT E PËRBASHKËTA BUJQËSORE EVROPIANE

Politikat e përbashkëta bujqëore, ishin prioritet i Traktatit të Romës dhe e njëjta ishte një element thelbësor i ndërtimit evropian. Në vitet e fundit kjo politikë shfrytëzon përafërsisht gjysmën e buxhetit të përbashkët evropian, edhe pse pesha demografike dhe ekonomike e bujqësisë është gjithnjë e më e vogël.

Për të arritur qëllimet madhore të ekuilibrit dhe të paqes që Evropa i kishte vënë vetës, bujqësia u konsiderua si një sektor strategjik, i cili duhej të ristrukturohet dhe të ishte më efikase për të siguruar pavarësinë ushqimore të kontinentit të vjetër.

Kjo politikë përfshinë tërësinë e masave dhe programeve të subvencionimit të bujqësisë në BE. Qëllimi i kësaj politike është që të sigurojë çmime të favorshme dhe cilësinë e pranueshme të produkteve bujqësore për konsumatorët evropian, të ardhurat e mjaftueshme për bujqit në BE si dhe ruajtjen e traditës rurale.

Politika e përbashkët bujqësore mbështetet në tri parime:

- a) Tregu i përbashkët – lëvizja e lirë e mallrave, përcaktimi i çmimeve të përbashkëta dhe ndihmës;
- b) Përparësia e BE-së – përparësit e produkteve të BE-së ndaj atyre të importuara, mbrojtja e tregut të brendshëm nga çregullimet e shkaktuara nga importi i produkteve bujqësore dhe çregullimeve në tregun botëror;
- c) Solidariteti financiar – kostot e politikës së përbashkët evropiane i ndajnë të gjitha shtetet anëtare së bashku.

Në fushën e politikës së përbashkët bujqësore kompetencat i ndajnë BE dhe shtetet anëtare, të gjitha vendimet mirren me shumicë të kualifikuar pas konsultimeve me Parlamentin Evropian.

Në perspektivën financiare politika e përbashkët evropiane financohet përmes Fondit Garantues Evropian të Bujqësisë dhe Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural. Politika e sotme e përbashkët bujqësore është rezultat i reformave të filluara në vitin 1992 dhe të vazhduara në vitet 1997 dhe 2003. Në kuadër të reformës që ka filluar në vitin 1992 ishte paraparë zvogëlimi i çmimeve të produkteve bujqësore dhe ushqimore me qëllim të rritjes së konkurrencës në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm, ndërsa ulja e të ardhurave të bujqëve janë kompenzuar me pagesa direkte. Po ashtu, përmes saj janë aplikuar dhe shumë masa të tjera me qëllim të rregullimit të tregut dhe mbrojtjes së ambientit jetësor.

Reforma e politikës agrare ka vazhduar në vitin 1997 në pajtim me “Axehtënda 2000”, përmes së cilës e njëjta politikë është organizuar përmes dy shtyllave: bujqësia dhe zhvillimi rural, ku është vazhduar ulja e çmimeve të produkteve bujqësore, është rritur niveli i pagesave direkte, si dhe aprovohen shumë masa stimulative për zhvillimin e fshatrave. Me këtë reformë është paraparë dhe pagesa unike e bujqut sipas pronës, pavarësisht nga vëllimi i prodhimit, ndërlikohet e

pagesës me respektimin e standardeve që kanë të bëjnë me ambientin jetësor, sigurisë së ushqimit, shëndetin e bimëve dhe kafshëve dhe forcimi i politikës rurale.

Sa është pjesëmarrja e rajoneve rurale në BE?

Rajonet rurale përfshinë më tepër se **77 % të hapsirës totale të BE-së** (47 % tokë bujqësore dhe 30 % pyje) dhe në këto rajone jeton përafërsisht gjysma e popullatës së BE-së (bashkësitë bujqësore dhe popullata tjetër).

Sa është numri i bujqëve në BE?

Në BE janë të regjistruar më tepër se 12 milionë bujq me orarë të plotë të punës. Bujqësia dhe industria ushqimore, që në masë të madhe varet nga furnizimi i sektorit bujqësor, kanë pjesëmarrje të përbashkët rreth 6 % në GDP totale të BE-së, rreth 15 milionë ndërmarrje dhe rreth 46 milionë vende të përhershme të punës.

Cilat janë llojet e ekonomive bujqësore në BE?

Llojet e ekonomive bujqësore në BE janë të shumëllojshme, dhe përfshinë bujqësinë intensive, klasike dhe organike. Me hyrjen e 12 shteteve të reja në BE, kjo dallueshmëri është rritur edhe më shumë.

Në BE ka rreth 12 milionë bujq, ndërsa një ekonomi bujqësore mesatarisht përfshinë rreth 15 hektar (në krahasim me SHBA që kanë 2 milionë bujq ndërsa madhësia mesatare e ekonomisë bujqësore ka rreth 180 hektar).

A e përkrah BE „modelin evropian bujqësor“?

Po. Politika e përbashkët evropiane tenton që ta përkrahë dhe siguroj cilësinë e ushqimit (në kontestin e ndryshimeve klimatike) dhe të siguroj zhvillimin e barabartë dhe harmonik të të gjitha rajoneve rurale të BE-së.

Ky lloj i bujqësisë duhet të jetë shumëdimensional. Ajo duhet të përgjigjet në brengat e qytetarëve sa i përket ushqimit (ofrimit të ushqimit, çmimeve, llojlojshmërisë, cilësisë dhe sigurisë) mbrojtjen e ambientit jetësor dhe që t'i u mundësohet bujqëve që të jetojnë në mënyrë cilësore nga veprimtaria e tyre.

Çka është Politika e përbashkët bujqësore?

PPB i u mundëson bujqëve që t'i u sigurojnë ushqimin më tepër se 500 milionë konsumatorëve të BE. Qëllimet kryesore janë që bujqëve të ju sigurojë një jetë të dinjitetshme, të sigurojë një furnizim stabil dhe të sigurtë me ushqime të nevojshme, sipas çmimeve të pranueshme nga konsumatorët.

PPB ka patur një zhvillim të hovshëm, që nga fillimi i funksionimit të saj në vitin 1962, ndërsaq në dekadën e fundit ka dhe një zhvillim më të hovshëm. Me reformën e vitit 2013 janë përcaktuar tri prioritete të reja:

- a) Të sigurohet prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit;

- b) Të sigurohet qeverisja e qëndrueshme me resurset natyrore;
- c) Të stimulohet zhvillimi më harmonik i të gjitha rajoneve në kuadër të BE-së.

ORGANIZIMI I PËRBASHKËT I TREGJEVE DERI NË FILLIM TË VITEVE 1990

Ndërhyrjet evropiane në bujqësi kanë shkallë të ndryshme intensiteti në varësi prej produkteve: rreth 70% të tyre për shembull, drithrat, produktet e qumshetit, mishi i gjedheve dhe sheqeri, janë shumë të mbrojtura, çmimi i tyre është i mbështetur dhe prodhimi është i garantuar nga importet; 25% prej tyre ku përfshihen: shpendët, vezët, mishi i derrit, vera, lulet dhe shumica e fruteve dhe perimeve, kanë vetëm mbrojtje të jashtme nëpërmjet taksave doganore dhe kuotave mbi importet; kurse produktet e tjera kanë përfituar ndihmë vetëm për të ruajtur çmimet e konsumit të ulët.

Për një kohë të gjatë, përcaktimi i cmimeve bujqësore ka qenë lavdia e organizimit të përbashkët të tregjeve dhe fiksimi i tyre nga Këshilli i ministrave të bujqësisë ka qënë një moment i rëndësishëm i jetës komunitare. Për çdo produkt, përcaktohet një çmim reference ose çmimi indikativ. Ky është çmimi të cilin Këshilli synon të organizojë tregun dhe që konsiderohet si i drejtë për prodhuesit bujqësor të komunitetit. Ai lejon të vendoset një çmim prag, më i ulët, një diferencë që përkon me çmimet e transporteve dhe të sigurimit deri në vendin e shpërndarjes. Kjo taksë variable, që varet nga diferenca midis çmimeve botërore dhe çmimeve prag, do të mbrojtë Evropën bujqësore kundër importeve. Çmimi prag u hoq në vitin 1995 dhe tani ekziston një çmim i ndërhyrjes që është çmimi minimal me të cilin prodhuesit janë të sigurtë se do të shesin të gjithë prodhimin. Nëse çmimi i tregut është më i ulët, automatikisht duhet të blejë një pjesë të prodhimit me qëllim që të rritin kursin. Në këtë rast PPB në kuadër të BE-së ndërhyjnë me anë të politikës së çmimeve të garantuara.

Në planin e jashtëm, Evropa imponon taksa variable mbi importet që kanë çmim më të ulët se çmimi i garantuar evropian me qëllim të kufizimit të konkurrencës ndërkombëtare. Ajo po ashtu subvencionon prodhuesit evropian që deshirojnë të

eksportojnë me qëllim që çmimi i tyre të ulet në nivelin e kurseve (çmimeve) botërore. Në vitin 1975, BE vendosi që të jep subvencione dhe kushte preferenciale huaje me qëllim të sigurimit të vazhdueshmërisë së aktiviteteve bujqësore si dhe ruajtjen e një hapsire natyrore në zonat malore. Me zbatimin e këtyre masave prodhimi është nxitur ndjeshëm nga mbështetja e çmimeve të brendshme, subvencionet për eksport, mbrojtja kundër importeve si dhe përmes zgjerimit të tregut për shkak të hyrjes së vendeve të reja në BE. Por nga ana tjetër, këmbimet bujqësore në mes vendeve evropiane nuk kanë quar në ndonjë specializim lidhur me avantazhet krahasuese.

Sistemi i çmimeve të garantuara, që sundon PPB që nga viti 1992 ka një efekt të dyfishtë cekuilibrimi duke favorizuar ofertën e brendshme dhe në një masë më të vogël, duke mos nxitur konsumin e brendshëm. Kjo diferencë në mes të ofertës dhe kërkesës shkakton teprica të prodhimit që duhet të qarkullojnë në tregjet e jashtme. Për këtë qëllim duhet të përdoren subvencionet eksportuese me qëllim që të rritet konkurueshmëria e çmimit të prodhimit evropian. Këto subvencione duhet të financohen përmes një rritjeje të shpenzimeve buxhetore dhe një takse shtesë mbi taksapaguesit evropian. Në planin e brendshëm, fitimet e fermerëve do të rriten, por në dëm të konsumatorëve, të cilët do të jenë të detyruar që të paguajnë çmime më të larta dhe taksapaguesve që do të financojnë në mënyrë indirekte subvencionet dhe shpenzimet për të mirëmbajtur dhe qarkulluar stoqet e krijuara nga mbiprodhimi. Kjo politikë do të ketë pasoja edhe në nivelin ndërkombëtar, pasi që oferta e vendeve të tjera, kryesisht e vendeve që gjinden në zhvillim e sipër, do të konkurrohet nga prodhimi evropian, ndërsa hyrja e tyre në tregun evropian vështërsohet nga taksat mbi importin e produkteve bujqësore.

Reformat në kuadër të PPB pas vitit 1990, synonin që të ndryshohet logjika e mbështetjes me anë të çmimeve ose me anë të skemës që ekzistonte më parë: ulja me 35% e çmimeve të rregullizuara për drithrat dhe për prodhimet tjera, dhe kompensimi në formën e ndihmave për hektar për fermerët që pranojnë të ngrijnë 15% të tokave të tyre prodhuese. Ndërsa, reforma e vitit 2003, kishte të bënte me futjen e një “pagimi” të vetëm të shkëputur nga prodhimi dhe nga faktorët e prodhimit. Në fakt, tani e tutje, reforma krijon të drejtën jo për të prodhuar, por për të marrë një subvencion nga BE (“e drejta e pagimit të vetëm”), me ç’rast tani e tutje e ardhura e fermerëve do të ketë dy burime: aktivitetin e prodhimit dhe rolin mjedisor.

Organizimi i tregjeve bujqësore kanë ndodhur në një kontekst historik të karakterizuar nga përballja midis dy fuqive shumë të ndjeshme ndaj shqetësimeve të fshatarësisë së tyre, Evropa dhe SHBA, dhe nga dalja në skenë e vendeve që duan të zhvillojnë bujqësinë e tyre për të arritur vetëmjaftueshmërinë dhe për të përfituar burime financiare të domosdoshme për zhvillimin e tyre ekonomiko-social përmes eksporteve bujqësore.

PPB paraqet komponenten më të rëndësishme të së drejtës së BE-së, pasi që rreth 50% të *acquis-it* (**Acquis communautaire**, term frengjisht dhe nënkupton tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore të Komunitetit Evropian qysh kur u krijua. Ato duhen miratuar dhe respektuar nga të gjitha shtetet e reja anëtare), ka të bëjë me rregullimin e kësaj politike.¹ (Vidović, Božena, (2010), "Zajednička poljoprivredna politika", *Evropska unija, MATE, Zagreb, fq. 420.*) Po ashtu, rëndësia e zbatimit të PPB ka të bëjë edhe me faktin se e njeta politikë me dekada shpenzonte pjesën më të madhe të mjeteve nga Buxheti i BE-së, me qëllim që të implementohej e njëjta. (Pjesëmarrja e mjeteve të ndara për zbatimin e PPB nga buxheti i BE-së, nga vitet e '70 të shekullit të kaluar gradualisht kanë filluar të bi, p.sh. në vitin 1971 për implementimin e kësaj politike janë shpenzuar rreth 85% të buxhetit të BE-së, në vitin 1985 kjo pjesëmarrje bie në 70%, në vitin 1985 në 51%, në vitin 2003 në 45% për t'u ulur në nivelin e vetëm 33% në vitin 2009).

PPB paraqet një nga politikat më të rëndësishme të BE-së, pasi që për dallim nga politikat ekonomike të tjera sektoriale, mjetet financiare që përdoren për sendërtimin e saj ekskluzivisht sigurohen vetëm nga buxheti i përbashkët i BE-së, por nga ana tjetër realizimi i kësaj politike është nën kompetencën e plotë të Komisionit Evropian.

Rëndësia ekonomike e PPB më së shumti vie në shprehje në tregtinë ndërkombëtare me produkte bujqësore në mes të BE-së dhe shteteve të treta. Pasi që kontinenti evropian pas Luftës së Dytë Botërore nuk ishte në gjendje që me prodhimin e saj të siguroj nevojat e saja me produkte bujqësore, ajo ishte e detyruar që të importonte sasi të mëdha të ushqimeve. Në dekadat e ardhshme falë implementimit intenziv dhe konsekuent të PPB, me kalimin e kohës BE u shëndërrua në një prodhues dhe eksportues shumë të rëndësishëm të produkteve bujqësore në nivel botëror.

Përveç elementeve të cekura më parë, rëndësia e bujqësisë për kontinentin e vjetër është e rëndësishme pasi që rreth 90% të sipërfaqës tokësore të shteteve të BE-së e përbëjnë tokat bujqësore dhe malet.

Prandaj kjo politikë me të drejtë llogaritet si një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetesës, shtimin më të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik, stimulimin e marrëdhënieve tregtare, por dhe për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Qëllimet e PPB në kuadër të BE-së, reflektohen në:

- Rritjen e produktivitetit të prodhimtarisë bujqësore,
- Sigurimin e standardit të nevojshëm jetësor për të punësuarit në këtë veprimtari,
- Sigurimin e çmimeve stabile dhe të parashikueshme për produktet bujqësore,
- Furnizimin e papenguar të konsumatorëve me këto produkte me çmime të pranueshme dhe unike,
- Solidaritetin financiar, dhe
- Tretmanin preferencial të produkteve bujqësore nga BE.

Arsyet për implementimin e politikës së përbashkët bujqësore

Për realizimin e qëllimeve më parë të theksuara të PPB, në praktikë përdoren mekanizmat dhe instrumentet e ndryshme, ndër më të rëndësishmet janë: doganat, çmimet e mbrojtura përmes intervenimit në tregun e brendshëm, kufizimi i importeve, subvencionimi i prodhuesve, avancimi i kapaciteteve prodhuese përmes përkrahjes financiare, përmirësimin të strukturës së plasmanit të produkteve bujqësore, programet e veçanta të subvencionimit, etj.

Edhe pse zbatimi i PPB ishte i suksesshëm në realizimin e qëllimeve të parashtruara, mekanizmat dhe instrumentet që janë përdorur për rregullimin e tregut, me kalimin e kohës kanë shkaktuar probleme të ndryshme politike dhe ekonomike, por edhe probleme me mbrojtjen e ambientit jetësor. Çmimet e produkteve bujqësore mbaheshin në mënyrë jo reale në nivele të larta dhe si çmime

të garantuara nuk ishin rezultat i veprimit të mekanizmave të tregut, me ç'rast PPB ishte një politikë me karakter proteksionist.

Qëllimet e PPB janë të formuluar në të drejtën sekondare të BE-së, dhe më së shpeshti paraqiten në formë të principeve (parimeve), nga të cilat më të rëndësishme janë: (Vidović, Božena, (2010), "Zajednička poljoprivredna politika", *Europska unija, MATE, Zagreb, fq. 426*)

1. **Parimi i tregut** – ka të bëjë me a) lirinë e qarkullimit të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm (pa dogana, pa kufizime sasiore ose pengesa të tjera të brendshme, por njëkohësisht duke i ruajtur të gjitha barrierat në tregti ndaj shteteve joanëtare të BE-së); dhe b) realizimi (përvetësimi) vetanak i të hyrave të prodhuesve bujqësor përmes shitjes së produkteve bujqësore për të cilat nuk janë lejuar subvencionet;
2. **Parimi i përparësisë së produkteve të BE-së** – ka të bëjë me faktin se produktet vendore bujqësore (produktet e BE-së) kanë përparësi absolute në krahasim me produktet e importuara; me çka njëherit sigurohet mbrojtja e tregut të përbashkët nga importi i produkteve të importuara nga shtetet e treta, si dhe nga fluktuacionet (lëvizja) e çmimeve në tregjet botërore të produkteve bujqësore;
3. **Parimi i solidaritetit financiar** – që paraqitet si pasojë e dy parimeve të mërrparshme; pasi që PPB e BE-së ka karakter të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare, rezulton se edhe shpenzimet për zbatimin e kësaj politike janë të përbashkëta, prandaj dhe kostot për zbatimin e kësaj politike të rëndësishme financohen nga fondet e veçanta të BE-së, dhe atë përmes: a) Fondit Evropian për Garancionet në Bujqësi (*European Agricultural Guarantee Fund-EAGF*) dhe b) Fondit Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (*European Agricultural Fund for Rural Development-EAFRD*).

Procesi i vendimarrjes për PPB në kuadër të BE-së

Pjesa më e madhe e Acquis-it (rreth 50%) ka të bëjë me rregullimin e funksionimit të PPB. Pasi që dispozitat e kësaj politike ndryshojnë shumë shpesh, por njëkohësisht dhe evoluojnë, kompetencat për marrjen e vendimeve në këtë komponentë të tregut të përbashkët është në kompetencë të institucioneve të BE-së, pasi që në BE çdo vit aprovohen më tepër se 3,000 akte të reja ligjore, rezulton se rregullativa ligjore në këtë fushë është voluminoze dhe e shumëllojshme (Vidović, Božena, (2010), "Zajednička poljoprivredna politika", *Europska unija, MATE, Zagreb, fq. 427*). Shumë nga aktet ligjore të aprovuara kanë karakter afatshkurtër,

pasi që kanë të bëjnë me përcaktimin e subvencioneve, përshtatjen e çmimeve, ndalesat dhe pagesat e ndryshme e të ngjajshme.

Komisioni Evropian ka për detyrë që të inicoj dhe propozoj aprovimin e zgjidhjeve të reja ligjore, deri sa Këshilli i BE-së i merrë vendimet përfundimtare në lidhje me PPB dhe atë me shumicë të kualifikuar. Parlamenti Evropian që nga fillimi sa i përket PPB ka vetëm rolin konsultativ (këshilldhënës). Gjatë realizimit të qëllimeve të PPB, Këshilli i BE-së i aprovon të gjitha llojet e instrumenteve juridike të së drejtës evropiane, siç janë: direktivat, rregullat, vendimet, etj.

Një nga specifikat e veçanta të kësaj politike ka të bëjë më veprimin e fuqishëm të grupeve të interesit që shpeshë herë edhe drejtëpërsëdrejti veprojnë në marrjen e vendimeve në lidhje me PPB në kuadër të BE-së. Këto grupe të interesit që veprojnë si në nivelin nacional ashtu edhe në atë mbinacional në nivel të BE-së. Momentalisht në BE ekzistojnë rreth 59 organizata profesionale që mirren me agrolibimin. Si organizata më të rëndësishme janë: Komiteti Evropian i Organizatave Bujqësore (*European Committee of Agricultural Organizations*) dhe Komiteti i Përgjithshëm për Bashkëpunimin Bujqësor (*General Committee of Agricultural Co-operation*), si dy institucione kyçe që i përfaqësojnë interesat e të gjithë prodhuesve bujqësor dhe selitë e tyre i kanë në Bruksel. Përveç këtyre dy organizatave që i përfaqësojnë dhe i mbrojnë interesat e vetëm disa grupeve të prodhuesve, procesi i lobimit shtrihet dhe përmes mbajtjes së takimeve dhe konsultimeve të ndryshme me vendimarrësit kryesor në kuadër të BE-së, dërgimin e lajmërimeve të ndryshme si dhe dhënien e mendimeve në lidhje me çështjet e caktuara.

Si mekanizmat më të rëndësishëm individual për rregullimin e tregut me qëllim të zbatimit të Politikave të Përbashkëta Evropiane janë: (Vidović, Božena, (2010), "Zajednička poljoprivredna politika", *Europska unija*, MATE, Zagreb, fq. 430)

1. **Çmimi i targetuar** (*target price*) – si çmim i garantuar minimal për produktet bujqësore që vlenë por dhe aplikohet në të gjitha shtetet anëtare të BE-së;
2. **Çmimi intervent** (*intervention price*) – si çmim me të cilin agjencionet e ndryshme ndërmjetësuese i blejnë tepricat e produkteve bujqësore në sasi të pakufizuara; fjala është për blerjet e garantuara të produkteve teprice në tregun e përbashkët;

3. **Çmimi hyrës** (*entry price*) – si çmim minimal sipas të cilit produktet bujqësore mund të importohen në tregun e përbashkët të BE-së;
4. **Dogana** – që paguhet gjatë importit të produkteve bujqësore me qëllim të ngritjes së këtyre çmimeve në nivelin e çmimeve hyrëse, dhe në këtë rast të njëjtat paraqesin një nga burimet (të hyrat) më të rëndësishme të buxhetit të BE-së; dhe
5. **Kthimi i mjeteve monetare nga buxheti i BE-së** – mjete që i janë dedikuar eksportuesve të produkteve bujqësore nga BE, me qëllim që të njëjtit të kompenzohen për dallimin në mes të çmimeve më të larta evropiane, në njërën anë, dhe çmimeve më të ulëta botërore nga ana tjetër, dhe në këtë mënyrë produktet bujqësore evropiane janë bërë më konkurruese në tregjet botërore.

Vlerësimi i Politikës së Përbashkët Bujqësore Evropiane (PPB)

Politika e Përbashkët Bujqësore është një nga politikat më të vjetra dhe kontradiktore të politikave të përbashkëta të BE-së, për shkak të disa arsyejeve: (*Prokopijević, Miroslav, (2012), Evropska unija-Uvod, treće dopunjeno izdanje, Službeni glasnik, Beograd, fq. 233-234.*)

1. Deri sa në kuadër të sektorit bujqësor të shteteve më të zhvilluara të BE-së (15 shtetet e para të BEE-së), krijohet vetëm 1 deri në 5% të GDP-së, nga ana tjetër për implementimin e PPB harxhohet rreth 40% të Buxhetit të përbashkët të BE-së, edhe pse të dalurat buxhetore për këtë politikë të përbashkët nga viti në vit po zvogëlohen në masë të dukshme;
2. Në përgjithësi kemi të bëjmë me një politikë të përbashkët që ka një kosto shumë të lartë financiare dhe se në shumicën e rasteve është e padrejtë për shtetet jashtë BE-së, dhe
3. PPB shkakton efekte negative për ambientin jetësor.

POLITIKA RAJONALE

Shteti si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare, zhvillohet dhe përparon vetëm në kushtet e favorshme dhe stabile ekonomike dhe politike. Por në kohën e krizës financiare, ka pasoja të shumta negative dhe implikon pasoja në të gjitha strukturat e shoqërisë.

Problemi i krizës ekonomiko–financiare nuk paraqetë një problem vetëm për Republikën e Kosovës, por dhe për Bashkimin Evropian që po tenton që t'i lehtësoj pasojat e kësaj krize dhe të trasojë rrugën më të sigurtë për zgjerimin e mëtejshëm të saj. Politika rajonale e BE-së është e rëndësishme si për shtetet anëtare ashtu edhe për shtetet që synojnë antarësimin sa më të shpejtë në familjen evropiane, shtete që gjithnjë e më shumë po përballen me ndryshime të shumta ekonomike dhe sociale.

Rëndësia dhe ndikimi i Politikave Rajonale të BE-së, është e konsiderueshme, pasi që shtetet anëtare garojnë për të marrë sa më shumë ndihmë financiare nga fondet strukturale evropiane. Një nga dilemat më të sheshta si në teorinë ashtu edhe në praktikën ekonomike është çështja se a mund të realizohen qëllimet e parashtruara të politikës ekonomike si dhe të rriten dhe efektet e politikave të tjera pa politikë të mirëfilltë rajonale, që zakonisht mundëson parakushte për efekte pozitive, rritjen e konkurrueshmërisë së rajonit me çka dhe sigurohet rritja e standardit jetësor.

Regjioni (nga fjala latine **region**), që do të thotë pjesë e sipërfaqës tokësore që karakterizohet me tipare specifike, (gjeofizike, ekonomike, politike, kulturore, etj.), çka e bënë të veçantë dhe të ndryshëm nga rajonet tjera. Përkufizimi i rajoneve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, nëse e marrim kriterin ekonomik, në radhë të parë bëhet sipas hapsirës së rrumbullaksuar ekonomike, në kuadër të të cilit subjektet ekonomike mund t'i zgjidhin problemet e shumta ekonomike dhe politikës vijuese ekonomike.

Në kuadër të një shteti, pavarësisht nga madhësia, rajoni paraqet një pjesë të rrumbullaksuar teritoriale, që nga një anë përmes veçorive specifike e ndërlidhë me shtetin, ndërsa nga ana tjetër e bënë specifike me disa karakteristika. (Republika e Kosovës është e ndarë në 7 rajone (Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë), ndërsa numri i komunave është 38, ndërsa numri i vendbanimeve është 1,469 (VSK – 2015, fq. 25).

Politika rajonale është një nga politikat më të vjetra të politikave të përbashkëta të BE-së. Nevoja e zvogëlimit dhe eliminimit të dallimeve në mes rajoneve të shteteve anëtare, është e përcaktuar me Traktatin për themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane (1957/1958), ndërsa politika rajonale është e përcaktuar me Aktin e Përbashkët Evropian (1967/1968) dhe përfundimisht me Marrëveshjen për Bashkimin Evropian (1992/1993). Me nënshkrimin e Aktit të Përbashkët Evropian

një nga qëllimet e rëndësishme është përcaktuar dhe kohezioni ekonomik-social, ndërsa me Marrveshjen për BE-në, politika rajonale është përcaktuar si politikë e përbashkët e BE-së.

Arsyet për implementimin e politikës së përbashkët evropane janë: të natyrës politike, me qëllim që të barazojë standardin jetësor të të gjithë qytetarëve të BE-së, si dhe të mbështetet në parimin e solidaritetit në mes shteteve anëtare të BE-së.

Natyra ekonomike e zbatimit të politikës rajonale rrjedhë nga teoria ekonomike e integritimeve (alokimi më i mirë i resurseve dhe specializimi, nga të cilat të gjithë partnerët do të kenë dobi të konsiderueshme) dhe teorisë së shtimit ekonomik. Në këtë rast, shtimi rajonal në teritorin e caktuar përcaktohet si kusht për zhvillim të mëtejshëm ekonomik.

Politika rajonale është një instrument i intervenimit të shtetit me qëllim që dallimet socioekonomike në mes pjesëve të ndryshme të shtetit të zvogëlohen dhe të krijohen parakushtet për një zhvillim sa më të balancuar. Ngecja zhvillimore e disa rajoneve, është një nga problemet kryesore të politikave ekonomike të BE-së. Problemet dhe ngecjet rajonale krijojnë disparitete të theksuara në nivelin e të ardhurave, shtimit të prodhimit dhe punësimit, etj.

Niveli i ndryshëm i zhvillueshmërisë të disa rajoneve në afate më të gjata kohore paraqet një nga pengesat më serioze për zhvillimin e qendrueshëm të ekonomive kombëtare. Qëllimi i zbatimit të politikës së përbashkët rajonale është zvogëlimi dhe eliminimi i dallimeve ekonomike dhe sociale në mes 28 shteteve anëtare dhe 278 rajoneve, me çka do të mundësohet zhvillimi i balancuar dhe harmonik në tërë teritorin e BE-së.

Një nga instrumentet më të rëndësishme për arritjen e kohezionit ekonomik dhe social të BE-së është politika rajonale që shpeshëherë dhe quhet politika kohezive.

Politika rajonale mbështetet në solidaritetin financiar, pasi që një pjesë e mjeteve që shtetet anëtare e paguajnë në buxhetin e BE-së, i'u ndahet rajoneve më pak të zhvilluara.

Në kuadër të politikës rajonale pjesa më e madhe e aktiviteteve është e orientuar në shtetet anëtare, respektivisht rajonet e tyre ku GDP e rajonit është nën 75% të mesatarës së GDP-së të BE-së. Kjo mbështetje financiare është e orientuar në

zhvillimin e infrastrukturës si dhe potencialeve ekonomike dhe njerëzore, me ç’rast këto mjete i shfrytëzojnë 18 shtete anëtare.

Në kuadër të politikës rajonale mbështetja është e orientuar në mbështetjen e zhvillimit inovativ dhe hulumtimeve shkencore, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, punësimit, si dhe në bashkëpunimin ndërkufitar në mes të rajoneve të ndryshme.

Instrumenti kryesor i zbatimit të politikës rajonale janë fondet strukturale dhe fondet kohezive. Rruga e solidaritetit në mes shteteve anëtare është zhvilluar në mënyrë graduale dhe ka kaluar nëpër disa etapa.

Në fazën e parë nga viti 1958 deri në 1975 me Traktatin e Romës të vitit 1957 është themeluar Bashkësia Ekonomike Evropiane, ndërsa marrëveshja është ratifikuar në vitin 1958. Në nënin 2 të kësaj Marrëveshje theksohen parimet në të cilat mbështetet Bashkësia Ekonomike Evropiane. Një nga to është se “Bashkësia avancoon dhe mundëson një zhvillim të qëndrueshëm, harmonik dhe të balancuar ekonomik“ dhe se kërkohet që të “zvogëlohen disproporcionet ekzistuese rajonale“. (Në këtë periudhë kishin të bënin vetëm me pjesën jugore të Italisë). Gjatë vitit 1958 u themeluan dy fonde: Fondi Social Evropian dhe Fondi për Menaxhim dhe Garancione në Bujqësi, me qëllim të ndihmës për zbatimin e politikave të përbashkëta evropiane.

Në takimin e kryetarëve të shteteve ose qeverive të BEE-së, që është mbajtur në vitin 1972 në Paris janë aprovuar edhe konkluzionet ku potencohet se politika rajonale “**është faktor parësor për forcimin e bashkimit**“.

Faza e dytë nga viti 1975 deri në vitin 1986, më ç’rast kriza e naftës e vitit 1973 ka përkeqësuar dukshëm situatën ekonomike globale, si dhe zgjerimi i parë i BE-së me Britaninë e Madhe, Irlandën dhe Danimarkën, ka shkaktuar probleme të caktuara strukturale në kuadër të BEE-së. Për këtë qëllim në vitin 1975 është themeluar Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal. Pas themelimit të këtij institucioni vije deri tek antarësimi i Greqisë në vitin 1981, Spanjës dhe Portugalisë në vitin 1986. Pas këtij zgjerimi dhe në pajtim me qendrimet e BE-së nga viti 1985 kanë filluar së funksionuari dhe fondet e integruara mesdhetare për ndihmë financiare për pjesën jugore të Francës dhe Italisë, e në radhë të parë për Greqinë, për të ndihmuar zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në disa rajone të këtyre shteteve.

Faza e tretë, nga viti 1986 deri në vitin 1999, kur dhe është aprovuar Akti i Përbashkët Evropian që ka mundësuar përshtatjen ndaj ndryshimeve pas zgjerimit, si dhe përgatitja e bazamentit për përmbylljen e projektit të tregut të përbashkët, me çka definitivisht është përcaktuar edhe bazamenti i politikës kohezive.

Politika kohezive e BE-së ka të bëjë me ndihmën rajoneve më të varfëra që bëhet nga ana e rajoneve më të pasura, me qëllim që të balancohen efektet për integrim më të suksesshëm ekonomik. Në qershor të vitit 2004, Komisioni Evropian ka vendosur që të bëjë reformimin e politikave kohezive gjatë periudhës buxhetore (2007-2013), dhe për këtë qëllim do të ndaheshin 336 miliardë euro përgjatë shtatë viteve, çka paraqet përafërsisht 1/3 e të gjitha shpenzimeve buxhetore të BE-së.

Qëllimet kryesore të kësaj politike kohezive ishin: konvergimi (mbështetja shtimit dhe hapja e vendeve të reja të punës në shtet anëtare dhe rajonet më pak të zhvilluara), konkurrenca dhe punësimi (ndihma shteteve të pasura anëtare në lidhje me ndryshimet shoqëro-ekonomike, globalizimit dhe kalimit në “shoqërinë e dijes”) dhe bashkëpunimi territorial (stimulimi i bashkëpunimit ndërkuftar, me qëllim të zgjidhjeve të përbashkëta për zhvillimin urban dhe rural).

Faza e katërt nga viti 2000 deri në vitin 2006. “Afhenda 2000” ishte në përgatitje që nga vitet e ‘90 për ti hapur rrugë zgjerimit më të madh të BE-së në vitin 2004 kur 10 shtete u bënë anëtare të BE-së. Me këtë zgjerim popullata e BE-së u rritë për 20%, ndërsa vlera e GDP-së vetëm për 5%, kështu që lartësia e të ardhurave për capita dhe shkalla e papunësisë në mes shteteve të pranuar ishte e lartë. Shteteve sapo të pranuar i’u mundësua shfrytëzimi i mjeteve të fondeve strukturale, duke përfshirë dhe fondet kohezive. Në pajtim me vendimin e Këshillit të Evropës nga viti 1999 buxheti i dedikuar për realizimin e politikës kohezive për periudhën 2000-2006 ishte 213 miliardë euro për 15 shtete anëtare. Me anëtarësimin e shteteve të reja u lejua alokimi plotësues prej 22 miliardë euro që i dedikoheshin shteteve sapo të pranuar në periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2006.

Faza e pestë nga viti 2007 deri në vitin 2013. Pjesa dërmuese e mjeteve financiare i janë dedikuar shteteve dhe rajoneve më të varfëra, ndërsaq prioriteti në shfrytëzimin e këtyre mjeteve i është dhënë zhvillimit ekonomik, hapjes së vendeve të reja të punës si dhe mbështetjes së hulumtimeve dhe inovacioneve.

Këshilli i Evropës në dhjetor të vitit 2005 ka alokuar 347 miliardë euro përmes fondeve strukturale dhe kohezive, nga e cila shumë 81.5% të mjeteve do të përdoren në rajonet që janë nën qëllimin parësor të konvergimit. Në bazë të procedurave të thjeshtësuara, në fund të vitit 2007, janë harmonizuar 436 programe që përfshinë të gjitha rajonet dhe shtetet anëtare të BE-së. Si një risi në financimin nga këto fonde ka të bëjë me rritjen e dukshme të mjeteve që do të dedikohen për ruajtjen e ambientit jetësor dhe për parandalimin e ndryshimeve klimatike

KORNIZA INSTITUCIONALE E POLITIKËS RAJONALE TË BE

Politika rajonale në kuadër të BE-së zbatohet në bazë të rolit mirë të definuar të çdo institucioni. Rolin kyç në zbatimin e politikës rajonale e ka Komisioni Evropian, që e ka të drejtën e lejimit të programeve strategjike, përcjellë zbatimin e tyre, merrë pjesë në hartimin e dokumenteve programore, si dhe mbikëqyrë mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të lejuara financiare. Në këto raste, Komisioni Evropian e përfaqëson interesin e BE-së si në tërësi dhe të qytetarëve të saj.

Komisioni Evropian jo vetëm që është iniciatorë dhe propozues i shpërndarjes së mjeteve të planifikuara financiare në kuadër të kornizës programore gjashtë vjeçare, por Komisioni lejon dhe programe për shtetet anëtare, në pajtim me mjetet e parapara sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave. Organi që aprovon vendimet më të rëndësishme në kuadër të BE-së është Këshilli i Ministrave, që i merrë vendimet finale për numrin më të madh të akteve juridike, po ashtu, nënshkruan marrveshje me shtetet jashtë BE-së dhe së bashku me Parlamentin Evropian vendos për aprovimin e buxhetit të BE-së. Këshillin e përbëjnë përfaqësuesit e shteteve anëtare, dhe çdo shtet e përfaqëson ministri i cili është i autorizuar që të përfaqësojë qeverinë e shtetit të vet.

Konvergimi - paraqet angazhimet me qëllim të promovimit të kushteve që mundësojnë faktorët e shtimit, që do të shpien në konvergencën reale të shteteve më pakë të zhvilluara, por dhe të rajoneve të tyre. Në mesin e 28 shteteve anëtare të BE-së, ky qëllim ka të bëjë me 89 rajone në 19 shtete anëtare.

Fondet strukturale dhe Fondi Koheziv janë “**motor**“ për realizimin e politikës kohezive ekonomike dhe sociale të BE-së dhe të njejtat janë në dispozicion vetëm për shtetet anëtare të BE-së. Mjetet financiare të këtyre fondeve shfrytëzohen për të

zvogëluar dallimet zhvillimore në mes rajoneve të ndryshme të BE-së, por dhe për t'u zvogëluar dallimet në standardin jetësor të qytetarëve të tyre.

Këshilli i Komunave Evropiane është themeluar në vitin 1951 në Gjenevë, ndërsa në vitin 1984 ka ndërruar emrin në Këshillin e Komunave dhe të rajoneve të Evropës. Sot në këtë Këshill janë të antarësuar më tepër se 100,000 njësi lokale dhe rajonale nga 29 shtete evropiane. Organi më i lartë i Këshillit, është Kuvendi i delegatëve, që zgjedhë numër të caktuar të përfaqësuesve të çdo shteti anëtar në Komitetin politik.

Këshilli stimulon bashkëpunimin ndër-rajonal dhe ndër-komunal në mes të shteteve, me qëllim të marrjes së mjeteve financiare nga programet e ndryshme të BE-së.

Kuvendi i Rajoneve Evropiane është themeluar në vitin 1985, dhe selia e tij është në Strazburg. Kuvendi përfaqëson më tepër se 300 rajone evropiane duke përfshirë dhe disa rajone që gjinden dhe jashtë kufijve të BE-së. Detyra parësore e Kuvendit është ndërtimi dhe forcimi i organeve politike që përfaqësojnë institucionet rajonale në institucionet e përbashkëta të BE-së, si dhe që të avancojnë më tej bashkëpunimin rajonal në mes shteteve anëtare.

Me Traktatin e Matrihtit të vitit 1992 është krijuar **Komiteti i Rajoneve** me seli në Bruksel, ku varësisht nga madhësia e shtetit, kuota e një shteti sillet nga 5 deri në 24 vende (ku Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia kanë nga 24 vende, Spanja dhe Polonia nga 21 vende, më së paku vende ka Malta vetëm 5), ndërsa shtetet kandidate për antarësim kanë statusin e vëzhguesit në Komitetin e Rajoneve. Ky Komitet duhet që të konsultohet para se në BE të mirren vendimet nga fusha e politikës rajonale, ambientit jetësor, shëndetit publik, kulturës, arsimit, transportit dhe që kanë të bëjnë me qeverisjen rajonale dhe lokale.

Anëtarët e Komitetit nominohen nga ana e qeverive të tyre nacionale, ndërsa i emëron Këshilli i BE-së me mandate 4 vjeçar dhe mund të rizgjedhen edhe për një mandat tjetër.

Në këtë periudhë për financimin e politikës rajonale në dispozicion të BE-së ishin këto fonde strukturale:

Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (European Regional Development Fund – ERDF), qëllimi parësor i të cilit ishte zvogëlimi i dallimeve rajonale si dhe

promovimi i shtimit të qëndrueshëm ekonomik, në kuadër të shteteve anëtare të BE-së;

Fondi Social Evropian (European Social Fund – ESF), qëllimi i të cilit ishte zhvillimi i resurseve humane dhe punësimit;

Fondi Evropian për Menaxhimin dhe Garancionet në Bujqësi (European Agricultural Guidance and Guarantees Fund – EAGGF)

Për periudhën e viteve 2007-2013 është përzgjedhur qasja e karakterit të shumëfishtë strategjik në krahasim me periudhat e mëparshme. Tani më shumë vie në shprehje ndërlidhja në mes të politikës kohezive dhe strategjive nga Lisbona dhe ajo e Geteborgut. Në këtë rast politika kohezive në masë të konsiderueshme drejtëpërdrejtë ndikon në realizimin e qëllimeve të parashtruara në këto dy strategji, pasi që në këtë rast zhvillimi dhe kohezioni përkrahen në mes tyre. Zvogëlimi i dallimeve ekonomike dhe sociale në kuadër të BE-së, mundëson që të gjitha rajonet dhe grupet sociale mund të ndikohet, por njëkohësisht mund të kontribuojnë dhe të kenë dobi nga zhvillimi i shpejtë ekonomik i BE-së. Nenet 3 dhe 158 të Marrëveshjes së BE-së po ashtu reflektojnë po këtë vision dhe për këtë arsye politika kohezive duhet të shikohet si pjesë përbërëse e strategjisë së Lisbonës dhe Geteborgut.

Instrumentet e ndihmës për paraantarësim (IPA) përbëhen prej 5 komponenteve:

1. **Ndihma për tranzicion dhe ndërtimin e institucioneve**, kjo komponentë e IPA-së është krijuar me qëllim të ndihmës në procesin e përafrimit me BE-në, si dhe në plotësimin e kriterëve dhe standardeve që i imponon procesi i antarësimit, në fushën e përvetësimit të legjislacionit dhe forcimit të kapaciteteve të institucioneve vendore.

2. **Bashkëpunimi ndërkufitar** – qëllimi parësor i kësaj komponente është afirmimi i raporteve të mira ndërshtetërore në mes shteteve si dhe bashkëpunimi rajonal në mes rajoneve si dhe rajoneve më pak të zhvilluara, përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta zhvillimore;

3. **Zhvillimi rajonal** – komponenta e 3 e IPA-së ka për qëllim që të avancoj kohezionin ekonomiko-social përmes zhvillimit të infrastrukturës transportuese, e në veçanti përmes përkrahjes së zhvillimit të rrjeteve nacionale të transportit si dhe

rrjeteve transevropiane, mbrojtjes së ambientit jetësor, furnizimit me ujë, ujrave të ndotura, cilësisë së ajrit, rehabilitimit të zonave të ndotura, efijencës së energjisë dhe ripërtrirjes së burimeve energjtike dhe zhvillimin e konkurrueshmërisë rajonale duke stimuluar ndërmarrësinë dhe punësimin;

4. **Zhvillimi i resurseve humane** – kjo komponentë ka për qëllim që të kontriboj në kohezionin ekonomik dhe social si dhe në realizimin e prioriteteve të Strategjisë Evropiane të Punësimit, në fushën e punësimit, shkollimit, trajnimit dhe inkluzionit social;

5. **Zhvillimi rural** – kjo komponentë ofron ndihmën për një zhvillim më të qendrueshëm bujqësor dhe rural përmes përmirësimit të efikasitetit të tregut dhe implementimit të standardeve të BE-së, ndihmës përmes krijimit të grupeve të prodhuesve dhe investimeve në përpunimin dhe plasmanin e produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkatarisë, zbatimit të masave në fushën e ambientit jetësor në bujqësi si dhe përmes përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rurale.

Bashkimi Evropian në krahasim me integrimet tjera ose blloqet tregtare, ka arritur nivelin më të lartë të integritit, çka mund të pasqyrohet përmes treguesve shumë dinamik të tregtisë intraindustriale. Përveç liberalizimit të plotë në lëvizjen e faktorëve prodhues, po ashtu janë harmonizuar edhe politikat makroekonomike, fiskale, monetare, tregtare, të sigurisë e politikat tjera në kuadër të shteteve anëtare. Themelimi dhe funksionimi i Unionit Monetar Evropian si dhe pranimi i një valute të përbashkët ka ndikuar në ndryshimin thelbësor të funksionimit të tërë sistemit ekonomik botëror. Po ashtu ky integrim ka ndikuar edhe në rritjen dhe avancimin e tregtisë me produkte industriale si dhe me shërbime me shtetet tjera të botës e që mund të shihet nga të dhënat e ndryshme statistikore.

Në shumë aspekte të funksionimit të saj, Bashkimi Evropian funksionon si një organizatë ndërkombëtare, pasi që është një bashkim i vullnetshëm i shteteve, ku shumë vendime mirren si rezultat i bisedimeve dhe marrëveshjeve në mes shteteve anëtare. Por nga ana tjetër, mund të konstatohet se BE-ja dallon nga organizatat tjera, pasi që ka një rëndësi më të madhe dhe se është më e komplikuar në funksionimin e saj, dhe se institucionet e saja kanë kompetenca ligjëvënse, në veçanti në hartimin e politikave të përbashkëta e që kanë karakter të detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare.

Në fushën e politikave publike, në të cilat shtetet anëtare kanë hequr autorizimet e tyre, e drejta e BE-së ka përparësi absolute ndaj sistemit juridik nacional të shteteve anëtare. Kështu p.sh. në fushat e tregtisë, bujqësisë, zhvillimit rajonal, konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorëve e politikave të tjera, procesi i vendimarrjes është i definuar dhe i përcaktuar vetëm në nivelin e BE-së. Ky fakt shpjegon dhe fenomenin e evropizimit, si një proces në kuadër të së cilit ligjet dhe politikat e shteteve anëtare të BE-së harmonizohen me legjislacionin dhe politikat e BE-së si një krijesë mbinacionale. Në këtë rast BE si një organizatë mbinacionale, ngritet mbi interesat e shteteve të veçanta dhe po ashtu merr vendime në bazë të interesave të përbashkëta të të gjitha shteteve anëtare.

Çka do të fitoj Republika e Kosovës nga politikat rajonale të BE?

Përmes zbatimit të legjislacionit evropian dhe zbatimit të politikave rajonale, Kosova do të ketë mundësi për modernizimin e infrastrukturës ekzistuese, ndërtimin e infrastrukturës sipas standardeve evropiane, të rritë konkurueshmërinë e saj në krahasim me tregjet tjera, t'i zhvilloj më shumë resurset humane, të përmirësoj cilësinë e jetesës së qytetarëve, por dhe të lidhet edhe më mirë me pjesën tjetër të BE-së.

Në periudhën afatgjatë, qytetarët e Republikës së Kosovës do ta rrisin standardin jetësor përmes fondeve të ndryshme evropiane, përmes këtyre mënyrave:

1. Përmes përmirësimit të infrastrukturës në disa fusha të veçanta do të rritet cilësia e jetës së qytetarëve

Përmes projekteve që do të përgaditen dhe kandidohen për financim në kuadër të Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal dhe Fondit Koheziv Kosova do të mund të ndërtoj një infrastrukturë të re në fushën e komunikacionit, energjetikës, mbrojtjes së ambientit jetësor, që drejtëpërdrejt do të ndikonte dukshëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve. E njëjta është vërtetuar nga praktika dhe përvoja e disa shteteve që janë antarësuar ose gjinden në procesin e paraantarësimit në BE.

2. Avancimi i sistemit të arsimit, punësimit, mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë përmes infrastrukturës përcjellëse

Përmes projekteve të Fondit Evropian Social dhe Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal, Kosova do të ketë mundësi që me kushte të volitshme financiare të financoj ndërtimin e qendrave të reja spitalore, shtëpive të pleqëve, çerdheve e

qendrave të reja për përgatitje profesionale, ku do të zhvilloheshin trajnimet për profesionet e caktuara dhe shtresa të caktuara sociale, me çka do të ndikohej edhe në uljen e shkallës së papunësisë.

3. Ekonomia kosovare do të zhvillohej më shpejtë dhe më qëndrueshëm, por nga ana tjetër do të jetë më konkurruese si në nivelin rajonal, të Bashkimit Evropian por dhe në tregun botëror. Pjesa më e madhe e projekteve të fondeve strukturale sipas rregullit do të orientohen në forcimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe rritjes së konkurrueshmërisë së tyre me qëllim të përballimit të konkurrencës globale.

4. Republika e Kosovës do të jetë më shumë e lidhur, por dhe në mënyrë më cilësore dhe institucionale me pjesën tjetër të BE dhe shtetet tjera të rajonit. Politika rajonale dhe kohezive e BE ofron mundësi të llojllojshme për zbatimin dhe realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar dhe territorial, që gjerë më tani është treguar si një instrument i rëndësishëm për ndërlidhjen e shteteve të ndryshme me BE. Zakonisht shtetet anëtare të BE-së i favorizojnë këto projekte me qëllim të avancimit të mirëqenies për qytetarët e rajoneve kufitare, forcimit të bashkëpunimit në mes rajoneve dhe shteteve anëtare me shtetet dhe rajonet që kanë perspektivë evropiane.

POLITIKA INDUSTRIALE EVROPIANE MIDIS POLITIKËS SË KONKURRENCËS DHE EKONOMISË SË NJOHJES

Politikat strukturale janë përsëri në rendin e ditës së BE-së për t'u bërë ballë dobësive relative të rritjes me të cilën po përballen shtetet evropiane. Ky objektivi strategjik është deklaruar në strategjinë e Lisbonës të përpunuar në Këshillin Evropian në mars të vitit 2000. Problemi qëndron në faktin se a të shkohet përsëri tek ambicia industriale që karakterizoi epokën e parë të ndërtimit evropian, e cila në mënyrë progresive i kishte lënë prioritetin e politikës së konkurrencës.

Hapat e para të Evropës janë kryer rreth ambicies industriale. Në fakt, Traktati i Parisit i vitit 1951, që krijoi Bashkësinë Evropiane të Thëngjillit dhe Çelikut (BETHÇ), ishte një projekt industrial i përmasave të mëdha dhe tregu i parë i përbashkët, në të njëjtën kohë. E njëjta ambicie udhëhiqte firmosjen e Traktatit Euroatom në vitin 1957, në lidhje me energjinë elektrike. Këto vende, që kishin

mungesa në lëndë energjetike tradicionale, me energjinë bërthamore kërkonin mjetin për të arritur pavarësinë energjetike.

Megjithatë, Traktati i Romës nuk do të përmbajë asnjë dispozitë të veçantë për sa i përket politikës industriale, dhe për më tepër, që nga viti 1965 BETHÇ do të integrohet tërësisht në institucione të tregut të përbashkët. Më pas në kuadër të BEE-së u bënë përpjekje për të rinovuar politikën industriale drejtë sektorëve të të ardhmes me programe ndihme për industritë tipike si programi: ESPRIT, që ka të bëjë me teknologjitë e informacionit dhe programit RACE që ka të bëjë me fushën e telekomunikacionit. Megjithatë, me disa përjashtime të rralla, gjatë periudhës që i parapriu nënshkrimit të Aktit Unik Evropian, në vitin 1986, politika industriale evropiane do të përpiqet të ndërtojë një mjedis të favorshëm për aktivitetin ekonomik pa ndikuar më shumë se çëduhet strategjitë e ndërmarrjeve.

Gjatë kësaj periudhe, strukturat industriale do të njohin ndryshime të rëndësishme, sektorët e industrisë tradicionale: metalurgjia, tekstili, automobilat u detyruan që të përshtaten me konkurrencën botërore, ndërsa një lëvizje e gjërë privatizimi që prekte të gjitha vendet evropiane po homogjenizonte strukturat juridike të ndërmarrjeve të mëdha, duke i dhënë fund ekzistencës së sektorit publik industrial evropian. Sot, prodhimi industrial në Evropë përfshinë pak më shumë se 20% të GDP-së së BE-së, ndërsaq punëson rreth 35 milionë persona, realizon rreth 75% të eksporteve të BE-së, por dhe 80% të shpenzimeve private në fushën e kërkimit dhe zhvillimit kanë të bëjnë vetëm me sektorin industrial.

Me Aktin Unik të vitit 1986, konkurrenca e industrisë evropiane konsiderohet si një veprim që duhet të mbikëqyret nga BEE, dhe tani nuk mjafton vetëm interesimi ndaj mjedisit të prodhimit industrial. Tani kjo politikë duhet të kalojë nëpërmjet krijimit të një sërë mjetesh që lehtësojnë aksesin e ndërmarrjeve në kapitale, partneritetin midis ndërmarrjeve dhe nga zhvillimi i promocionit të ndërmarrësisë. Parimet bazë të kësaj politike janë respektimi i konkurrencës dhe ai i vetërregullimit të tregut. Këto parime përmbliidhen në një dokument të nënshkruar nga komisioneri Bangeman në vitin 1990 i cili quhet: "politika industriale në një mjedis të hapur dhe konkurrues, linjat drejtuese për një qasje komunitare".

POLITIKA INDUSTRIALE DHE NDËRMARRËSIA

Ndërmarrësia dhe politika industrial e BE-së kanë për qëllim promovimin e konkurrueshmërisë me qëllim të avancimit të politikave ndërmarrëse dhe strategjive industriale. Të njejtat janë të orientuara në përshpejtimin e përshtatjeve strukturale, në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm afarist përmes tërheqjes së investimeve vendore dhe të huaja, promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe ndërmarrësisë dhe inovacioneve.

Në kuadër të BE-së, zhvillimi i konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe ndërmarrësisë është prioritet i këtij integrimi ekonomik. Legjislacioni i BE-së si dhe fondet ekzistuese mundësojnë që të krijohet një ekonomi konkurruese në kushtet e afarizmit global, ndryshimeve demografike dhe nevojës për një zhvillim të qendrueshëm ekonomik.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si një faktorë i rëndësishëm i shtimit dhe zhvillimit ekonomik dhe punësimit të ri, që do të mundësohej nga fondet e ndryshme të BE-së, do të orientohej në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë, përmes aplikimit të inovacioneve dhe teknologjisë bashkëkohore informative.

Përmes zhvillimit të këtyre sektorëve e që janë në ndërlidhje të drejtëpërdrejt me zhvillimin industrial, përmes politikës së definuar industriale dhe përmes zhvillimit të sektorëve strategjik industrial do të krijoheshin parakushtet për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të tregut si dhe të një ekonomie inovative.

POLITIKAT INDUSTRIALE NË BE

Qëllimi i zbatimit të politikave industriale të BE-së është rritja e konkurrueshmërisë së industrisë evropiane me qëllim që kjo veprimtari ta mbajë dhe ruaj rolin dhe funksionin e saj në zhvillimin dhe punësimin në Evropë.

Politika industriale ka shtrirje horizontale dhe qëllimi i saj parësor është që të siguroj parakushte për rritjen e konkurrencës në kuadër të veprimtarisë së industrisë. Po ashtu, politika industriale është kompatible edhe me politikat tjera ekonomike, siç janë: tregtia, tregu i brendshëm, hulumtimet dhe inovacionet, punësimi, mbrojtja e ambientit jetësor, shëndeti public, etj.

Politika industriale e BE-së, në veçanti është e orientuar në: 1) dinamizimin e përshtatjes së industrisë ndaj ndryshimeve strukturale; 2) krijimin e një ambienti të përshtatshëm për iniciativa dhe zhvillim të ndërmarrësisë, në veçanti të ndërmarrësve të vegjël dhe të mesëm, 3) krijimin e një ambient-rrethi të përshtatshëm për bashkëpunim në mes të ndërmarrësve, dhe 4) stimulimin e shfrytëzimit më të madh të potencialeve industriale, politikës së inovacioneve, hulumtimeve dhe zhvillimit teknologjik.

Instrumentet që i përdorë politika industrial e BE-së, në realitet janë instrumente të politikës ndërmarrëse, dhe kanë për qëllim që të krijojnë kushte të favorshme, në kuadër të së cilave, ndërmarrësit dhe ndërmarrjet do të kenë mundësi që të inicojnë iniciativat dhe mundësit e tyre më të mira.

POLITIKAT E KONKURRENCËS EVROPIANE

Politika e konkurrencës është segmenti kryesor i politikës industriale në BE. Në një situatë konkurrence të pastër dhe të përkryer çmimi i tregut është më i ulët se çmimi i praktikuar nga një monopol dhe sasi të ofruara në situatë konkurrence janë më të mëdha se sasi të ofruara në situatë monopoli. Konkurrenca bën që të eliminohen “rentat e monopolistit”, dhe kjo i takon pushtetit publik që të mbikëqyrë funksionimin konkurrues të tregjeve me anë të politikave antitrust.

Parimi i politikës së konkurrencës figuron në Traktatin e Romës të vitit 1957. Por politika e konkurrencës deri në vitet 1990, rrallëherë ishte në qendër të vëmendjes evropiane. Shpeshëherë, kjo praktikë është futur nga vetë procesi i integritimit, i cili e konsideron atë si element kryesor të politikës ekonomike strukturale në kontinentin e vjetër. Për disa vende si Franca dhe Gjermania, arsytet janë kryesisht kulturore dhe historike. Vendosja e një politike të konkurrencës kërkon që të përshtaten paraprakisht disa veçori me mekanizmat e tregut. Kështu, në Gjermani, legjislacioni i parë mbi konkurrencën u fut në vitin 1947 nga aleatët, ndërsa përforcimi i këtij legjislacioni dhe sidomos i zbatimit të tij është përfunduar në vitin 1980, ashtu edhe në Francë. Holanda priti vitin 1988 për të ngritur një autoritet të vërtetë konkurrence në nivel kombëtar, kurse shumica e vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore, pas rënies së murit të Berlinit, filluan shumë shpejtë një proces tranzicioni drejtë ekonomisë së tregut, çka e bëri të nevojshme

paisjen me një legjislacion konkurrence. Vendet që zgjodhën të antarësohen në BE e përshtatën shumë shpejtë legjislacionin e tyre me praktikën më të mira evropiane.

Sipas një formule të Komisionit, BE-ja ka si ambicie të “ruajë dhe zhvillojë një situatë konkurrence efikase duke vepruar mbi strukturat e tregut dhe sjelljet”. Politika e konkurrencës përpiket të shmangë pozicionet konkurruese dhe të sigurojë për të gjithë lirinë e hyrjes në treg, po ashtu theksohet se “ndalohet çdo praktikë që përpiket të pengojë, kufizojë, apo të dëmtojë konkurrencën”. Gjithashtu, ndalohen ndihmat e drejtëpërdrejta apo indirekte për të gjitha ato vende që dëmtojnë konkurrencën.

Komisioni Evropian pranon dhe shqyrton ankesat dhe nga ana tjetër ka kompetencën për të vendosur sanksione adekuate të parapara me legjislacionin e BE-së. Marrëveshjet horizontale, d.m.th. ato të arritura nga ndërmarrjet që shesin të njejtin produkt, ndalohen kur objektivi i tyre i vetëm është ndarja e tregut. Marrëveshjet vertikale ndalohen kur arrijnë të lidhin prodhuesit dhe shpërndarësit duke dëmtuar pavarësinë e sjelljeve të secilit prej tyre si në rastin e Volsvagenit. Por jurisprudenca evropiane lejon disa marrëveshje nëse të njejtat kanë për efekt një përmirësim nga i cili përfitojnë konsumatorët, si p.sh. për marrëveshjet që mundësojnë transfertat e teknologjive, po ashtu, edhe libri është një përjashtim në ndalesat e marrëveshjeve të çmimeve.

Zbatimi i rregullave të konkurrencës ka bërë që të përpunohen referencat juridike që përkufizojnë konceptet ndërmarrje dhe konkurrencë në të drejtën evropiane të biznesit dhe ku saktësohen të gjitha fushat që përjashtohen e të theksuara nëpër tekste. Për sa i përket termit konkurrencë, tekstet evropiane përpiqen të saktësojnë natyrën e konkurrencës së mbrojtur, format e konkurrencës së mbrojtur dhe kufizimet e konkurrencës së denueshme.

Tekstet evropiane angazhohen jo vetëm të mbrojnë konkurrencën aktuale të një tregu të caktuar dhe në një moment të caktuar por edhe konkurrencën potenciale d.m.th. atë që garanton aftësinë e një operatori për të hyrë në një treg ku nuk është ende i pranishëm. Rregullat e konkurrencës ndalojnë ujdite që kanë për efekt “të pengojnë, kufizojnë, dëmtojnë lojën e konkurrencës”. Konkurrenca është e penguar kur ajo mungon plotësisht. Në shumicën e rasteve është fjala për marrëveshje horizontale që shkojnë drejtë marrëveshjeve për çmimet ose për ndarjen e tregut, në këtë rast përdoret më shumë termi “kufizime të karakterizuara të konkurrencës”.

Situata e konkurrencës së dëmtuar tregon po aq për një situatë konkurrence të kufizuar ose për kushte të pabarabarta konkurrence për shkak të marrëveshjeve në mes disa protagonistëve të tregut. Komisioni, kur shqyrton një dosje të caktuar në lidhje me një shkelje të supozuar të rregullave të konkurrencës, duhet që të përcaktojë me korrektësi tregun e prekur, është fjala për tregun e produkteve për të cilin bëhet fjalë dhe për tregun gjeografik.

Tregu i produkteve përfshinë: "të gjitha produktet dhe/ose shërbimet që konsumatori i konsideron si të ndërkëmbyeshme ose të zëvendësueshme për shkak të karakteristikave të tyre, dhe të përdorimit për të cilin janë bërë".

Tregu gjeografik përfshinë: "territorin në të cilin ndërmarrjet angazhohen në shitjen e mallrave dhe shërbimeve, në të cilin kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene dhe që mund të dallohen nga zona gjeografike fqinje sepse kushtet e konkurrencës aty ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme".

Komisioni Evropian fillimisht përcakton se cili është tregu i produkteve dhe më pas merret me përkufizimin e tregut gjeografik, ndërsa më vonë kujdeset të verifikojë se në ç'mënyrë analiza e tregut në fjalë integrohet në kuadrin e tregut komunitar. Komisioni ndërmerr një punë të rëndësishme hetimi pranë konkurrentëve por edhe pranë përdoruesve. Në këtë mënyrë mund të mbledhë prova për të dhënë vendimin e tij. Në rast nevoje, ai ka të drejtë të kryejë inspektime ose të shkojë në vendndodhjen e palëve të pranishme në treg për të marrë informacione shtesë mbi proceset e prodhimit ose shitjes të produkteve përkatëse.

POLITIKA SOCIALE, EVROPA SOCIALE, SFIDA E MADHE

Nga Traktati i Romës e deri në vitet 1970, falë konjunkturës së përshtatshme ekonomike dhe sistemeve sociale të vendeve anëtare, modestia e orientimeve sociale nuk përbënte pengesë për ndërtimin evropian. Por logjika e konkurrencës së fortë që zhvillohet në të njëjtën kohë si dhe dallimet e shumta kombëtare, me kalimin e kohës, do të pengojnë këtë model social. Në ditët tona, rritja e dobët e aktivitetit ekonomik evropian, prania e papunësisë së madhe dhe pranimet e vendeve më pak të zhvilluara ekonomikisht, kanë ndryshuar ndjeshëm të dhënat e këtij problemi.

Mungesa e politikave të përbashkëta sociale nuk mund të pranohet më në Evropën e sotme moderne. Jo vetëm për arsye se efektet negative që ajo shkakton si dumping social dhe fiskal, por dhe prekin parimet e një konkurrence të shëndetshme midis shteteve anëtare, por edhe për arsye të kohezionit social dhe të demokracisë evropiane. Përgjegjësia ndaj çështjes sociale në ditët e sotme është kthyer në sfidën më madhore për të ardhmën e BE-së.

Nga Traktati i Romës deri në fund të viteve 1970, rritja ekonomike e qendrueshme që njohin “të gjashtët” dhe logjika e integritimit evropian që mbizotronte në atë kohë shpjegonë vendin modest që instancat komunitare u jepin çështjeve sociale. Konkretisht gjatë kësaj periudhe, progresi social konsiderohet si një pasojë e rritjes ekonomike. Nga njëra anë, progresi social vjen nga progresi ekonomik. Nga ana tjetër, duke qenë se politikat sociale dhe sistemet sociale janë të lidhura ngushtë me historinë, kulturat dhe sovranitetet kombëtare, përfitimet sociale nga rritja dhe nga integrimi rajonal do të pasqyrohen në kuadrin e strukturave sociale specifike të çdo shteti anëtar.

Politika sociale nuk mungonte në traktatin e themelimit, edhe pse vendi që zinte ishte modest. Ajo ka të bëjë me tri fusha të përcaktuara dhe një objektiv i përgjithshëm. Tri fushat – qarkullimi i lirë i punonjësve, barazia në trajtimin midis punëtorëve meshkuj dhe femra, mundësia e komunitetit evropian për ndërhyrje për të kufizuar rrezikun në rast dampingu social - nuk janë zgjedhje të rastësishme, ndër shumë mundësi sociale. Pra projekti fillestar i themeluesve është krejt funksionalist: socialja vjenë pas ekonomikes, vetëm rastet kur ajo rrezikon të dëmtojë objektivat ekonomike, justifikonte marrjen e iniciativave paraprake politike. Kjo konfirmohet edhe nga kalendari i Traktatit, i cili vendosë një afat prej 12 vitesh të ndarë në tri etapa për liberalizimin e këmbimeve, ndërsa politikat e përbashkëta në lidhje me harmonizimin dhe përshtatjen e legjislacioneve sociale dhe të punës të vendeve anëtare, konsiderohen si çështje që duhet të hapen më vonë.

Megjithatë, para kthesës së viteve 1980, ky konceptim minimalist i socialës do të vihet në diskutim nën presionin e disa ngjarjeve. (Greva e punëtorëve të fabrikës kombëtare të armëve të Herstak në Belgjikë në vitin 1966). Motivi i konfliktit është i thjeshtë dhe unik; pabarazia e pagave midis burrave dhe grave për të njëjtën punë. Për herë të parë kërkesa për barazimin në pagesa merrë formën e një kërkesë për të respektuar zbatimin e nenit 119 të Traktatit të Romës. Në fakt, delegacionet

e ndryshme sociale të cilat erdhën për të mbështetur grevën, do të mbështesnin gjithashtu kërkesat e punëtorëve për të respektuar nenet sociale të Traktatit të Romës. Aq i madh ishte efekti sa që të nesërmën e konfliktit, çështja e përshtatjes së legjislacionit kombëtar me nenin 119 do të shtrohen me terma politike, si në Komision, ashtu edhe në shtetet anëtare. Tensionet sociale që shoqërojnë rritjen ekonomike do të kontribuojnë gjithashtu në përcaktimin e të drejtës sociale komunitare në lindje e sipër, e cila nga ndihmëse e thjeshtë e tregut të përbashkët, do të bëhet gradualisht domosdoshmëri e drejtësisë sociale.

Nënshkrimi i Aktit Unik Evropian në vitin 1988 shënon etapën e parë të kësaj qasje të re të politikës sociale. Kështu politika sociale do të zë një vend më të rëndësishëm në fushën e shëndetit dhe të sigurisë në punë. Në të njëjtën kohë institucionalizohet praktika e dialogut social dhe parimi i kohezionit ekonomik dhe social, dhe i njëjti bëhet një objektiv evropian i vecantë, duke qenë se neni 138 favorizon harmonizimin e kushteve të shëndetit dhe të sigurisë në vendin e punës.

Në Traktatin e Mاستrihtit të vitit 1992, tejkalohet një prag i ri që mundëson përforsimin e pjesëve përbërse të modelit social evropian dhe modifikon pjesërisht, të funksionimit institucional të BE-së në fushën sociale. Sa i përket aspektit të parë u dha një shtyese e re, pasi që kohezioni social u kthye në një objektiv të veçantë të BE-së, si dhe u saktësuan detyrat e Fondit Social Evropian. Në të njëjtën kohë, të njëjtat janë përfshirë një protokoll social dhe një marrëveshje mbi politikën sociale.

Traktati i Amsterdimit (1997) dhe Këshilli i Tampere janë etapa vendimtare të njohjes së një politike evropiane sociale. Së pari Britania e Madhe u bashkua në kapitullin social të BE-së, dhe integrimi i saj në traktat u bë nëpërmjet një marrëveshjeje. Së dyti, u futën masat kundër përjashtimit social dhe ato për shtrirjen e shanseve të barabarta. Në këtë rast ky traktat integron një protokoll social me strategjinë evropiane të punësimit dhe iniciativa kundër formave të ndryshme të diskriminimit dhe më në fund dialogu social bëhet edhe pjesë përbërëse e qeverisjes evropiane.

POLITIKA SOCIALE

Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës sociale dhe punësimit është i përqëndruar në: fushën e të së drejtës së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, trajtimin të barabartë të gjinive të ndryshme sa i përket punësimit dhe sigurisë sociale, politikës së punësimit, dialogut social, etj.. Po ashtu në kuadër të këtij legjislacioni ekzistojnë dhe rregulla të veçanta për të gjitha shtete anëtare të BE-së e që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë racore apo etnike, religjionit dhe fesë, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual.

Qëllimet më të rëndësishme të politikës sociale të BE janë: arritja e qasjes së barabartë dhe të drejtë në shërbimet bazike sociale, avancimi i sistemit të mbrojtjes sociale, shkalla e lartë arsimore dhe profesionale e forcës së punës, shkalla e lartë e punësimit, siguri i të ardhurave të sigurta dhe të qëndrueshme, siguri i kushteve të pranueshme të punës për të punësuarit, etj..

Legjislacioni evropian i punës i mbronë të drejtat e punëtorëve në rastet e tepërçave kolektive, falimentimit, ndërrimit të lokacionit të afarizmit, të drejtën e punëtorëve për tu informuar dhe konsultuar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me interesat e tyre, rregullat që kanë të bëjnë me orarin e punës dhe sigurinë në punë, çështjeve të mbrojtjes së shëndetit, etj.. Bashkimi Evropian përmes legjislacionit dhe formave të tjera stimulon dhe nxitë marrëdhënie moderne të punës si dhe lehtëson dialogun social në mes të përfaqësuesve të punëtorëve (sindikave) dhe punëdhënësve (industrialistëve), me të vetmin qëllim për t'i mbrojtur të drejtat e të punësuarve por dhe rritjes së konkurrencës.

Në kuadër të BE-së është i dënueshëm diskriminimi në baza gjinore, racës, preardhjes etnike, invaliditetit, orientimit seksual, moshës, fesë ose bindjeve, me çka legjislacioni nga fusha e politikës sociale dhe punësimit është i orientuar dhe përkushtuar në krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë, ndalimin e diskriminimit në çfardo baza si dhe në forcimin e dialogut social. Po ashtu, me ndryshimin e legjislacionit të BE-së përmes disa masave efikase po e parandalon punën e palajmëruar (puna në të zezë), me qëllim që e gjithë forca punuese në tërë hapësirën e BE-së të gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta.

DALLIMET NE SISTEMIN E TATIMEVE

Në BE, politikat fiskale varen kryesisht nga shtetet anëtare. Nuk ekziston një taksë evropiane. Shtetet anëtare kanë sisteme të tatimeve heterogjene, që është fryt i traditave të tyre kombëtare dhe historisë së tyre. Sistemi i tatimeve është edhe simbol i sovranitetit. Në kuadër të BE dallohen tre sisteme tatimeve të detyrueshme:

- a) Tatimet e drejtëpërsëdrejta të paguara nga tatimpaguesit (tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi shoqëritë, tatimi mbi pasuritë, taksa lokale);
- b) Tatimet e tërthorta të marra mbi operacionet e prodhimit dhe konsumit (TVSH, taksa të akcizës mbi karburante, alkool dhe duhanin, etj), dhe
- c) Kuotat sociale të paguara nga të punësuarit dhe punëdhënësit për të garantuar mbrojtjen sociale të personave të siguruar në rast vështërsie eventuale (sëmundje, aksidenti në punë, papunësi, etj.) dhe në përgjithësi për të financuar sistemin e sigurimeve shoqërore.

BE-ja vepron kryesisht mbi tatimet e tërthorta, sepse janë pikërisht këto që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në tregun e brendshëm. Diferenca në nivelin e akcizës ose të TVSH-së mund të tërheqë ose të largojë konsumatorët dhe gjithashtu të dëmtojë parimin e neutralitetit fiskal të vendosur nga Traktati i KE-së. Për këtë arsye është parë e nevojshme të harmonizohet niveli i TVSH-së së vendeve të ndryshme, por harmonizimi nuk do të thotë dhe uniformizim. Niveli normal varion nga 15% për Luksemburgun dhe Qipron, në 25% për Danimarkën dhe Suedinë. Asnjë vend nuk mund të ndryshojë nivelet e tij në mënyrë të njëanshme. Nëse ai deshiron që të ulë TVSH-në, duhet që në fillim të marrë lejen e të gjithë partnerëve të tij (rregullativa në fuqi parasheh që vendimet në fushën përkatëse të merren me unanimitet). Për këtë arsye nga të punësuarit dhe punëdhënësit për të garantuar mbrojtjen, Franca nuk mund të ulë TVSH-në në sektorin e restoranteve pa lejen e të gjithë vendeve të tjera anëtare të BE-së.

Diferencat për sa i përket nivelit të akcizave janë edhe më të larta, edhe pse prej vitit 1992, ekziston një nivel minimal për produkt të caktuar. Në vitin 2003, vlera minimale për hektolitër alkool të pastër shkente në 550 euro, por e njejta varionte nga 645 euro në Itali deri në 5,500 euro në Suedi. Dallimet janë gjithashtu shumë

të mëdha për duhanin, gjë që inkurajon trafiqet e ndryshme, deri edhe kontrabandimin.

Rregullat kryesore evropiane në lidhje me fiskalitetin kanë si synim:

- a) Të shmangin tatimin e dyfishtë të shoqërive, sidomos kur është fjala për shoqëritë mëmë dhe filialet e tyre të vendosura në shumë shtete anëtare;
- b) Të harmonizojnë fiskalitetin e kursimit, sepse shtetasit evropian tashmë janë të lirë të vendosin paratë e tyre në cilin vend të duan të BE-së. Në mungesë të harmonizimit të niveleve të tatimit, mund të shfaqet një konkurrencë fiskale. Pikërisht për të parandaluar këtë rrezik në të gjitha vendet e BE-së është konstatuar një ulje e tatimeve për kursim; dhe
- c) Zhvillimi i një bashkëpunimi evropian në fushën e luftës kundër mashtrimit fiskal

UNIONI MONETAR EVROPIAN

Shtetet anëtare të BE-së që kanë pranuar euron si valutë të tyre të përbashkët përbëjnë Unionin Monetar Evropian (UME). Unioni monetar paraqet nivelin më të lartë të integritetit evropian dhe i njëjti mbështetet në: harmonizimin e politikave monetare të shteteve anëtare dhe përdorimin e valutës së përbashkët, krijimin e rezervave të përbashkëta monetare, krijimin e bankës së përbashkët qendrore dhe zbatimit të politikës së përbashkët monetare.

Themelimi i UME ishte dëshirë e kahershme e ideatorëve të themalimit të BE, me qëllim të sigurimit të nivelit të duhur të stabilitetit financiar dhe ruajtjen në nivele të pranueshme të stabilitetit të cmimeve në shtetet anëtare.


Anëtarësimi i një shteti të Bashkimit Evropian në Unionin Monetar Evropian, nënkupton:

- Valutën e përbashkët të shteteve anëtare të UME- Euro;
- Politikën e përbashkët monetare që në rastin konkret e udhëheqë Banka Qendrore Evropiane (BQE);
- Koordinimin e përafërt dhe të pandërprerë në mes shteteve anëtare me qëllim të koncipimit të politikës së përbashkët ekonomike;
- Koordinimin e politikës fiskale përmes masave të kufizimit të borxhit publik dhe deficitit buxhetor.

Banka Qendrore Evropiane (ECB - European Central Bank), me seli në Frankfurt në Majn, drejton dhe menaxhon politikën monetare dhe së bashku me Bankat Qendrore kombëtare të shteteve anëtare të BE-së përbëjnë Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (**ESCB - European System of Central Banks**).

Me Traktatin e Lisbonës në lidhje me funksionimin e BE-së, Banka Qendrore Evropiane ka marrë statusin e institucionit financiar të BE-së. Roli kryesor i BQE-së është emitimi dhe menaxhimi i euros, ruajtja e stabilitetit të çmimeve për më tepër se 330 milionë banor në 19 shtete anëtare të UME.

Kronologjia e anëtarësimit të shteteve në Eurozonë



Jashtë eurozonës janë këto shtete anëtare të BE-së:

(Britania e Madhe, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Kroacia, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Suedia)

Përveç shteteve anëtare të eurozonës, euron si mjet pagese e përdorin edhe Monako, San Marino, Vatikani, Lihenshtajni dhe Andora, që më parë kanë nënshkruar marrëveshje me BE-në për përdorimin e euros si mjet pagese, ndërsa e njëjta valutë si mjetë pagese përdoret edhe në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Malit të Zi.

Procesi i antarësimit të një shteti në BE është shumë më i lehtë se antarësimi në UME, pasi që shtetet candidate duhet që ekonominë e tyre kombëtare së paku për dy vite ta përshtasin me mekanizmin evropian të kurseve devizore ("ERM II"), gjatë së cilës periudhë shteti kandidat siguron konvergjencën ekonomike duke e ruajtur kursin devizor të valutës kombëtare në suaza të shmangieve të lejuara ($\pm 15\%$), në krahasim me euron. Kriteret për antarësim në UME, ose që ndryshe

quhet faza e tretë e konvergencës, janë të definuara përmes Traktatit të Mastrohitit nga viti 1992 dhe shpeshëherë njihen si „**Kriteret e Mastrohitit**”.

Çka janë kriteret e Mastrohitit:

- Realizimi i normave të larta të stabilitetit të çmimeve. Norma e inflacionit mund të jetë më së shumti deri në 1,5% më e lartë se norma e inflacionit të tre shteteve me normë më të ulët të inflacionit;
- Ruajtja e stabilitetit të financave publike në raport me vlerat referente:
 - deficiti buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 3% e vlerës së GDP-së, të matur me çmimet e tregut;
 - borxhi publik nuk mund të jetë më i lartë se 60% e GDP-së, të matur me çmimet e tregut;
- Stabiliteti i normave të kamatave (interesit) në bonot e thesarit të qeverisë ose në letrat me vlerë të krahasueshme. Norma afatgjate e kamatës–norma mesatare afatgjate e kamatës nuk guxon që të jetë më e lartë se 2% e mesatares së tre shteteve anëtare më të suksesshme (shtetet që kanë normë më të ulët të interesit dhe inflacionit).

Përveç plotësimit të kriterëve ekonomike për antarësim në UEM, të gjitha shtetet janë të obliguara që të plotësojnë edhe kriteret institucionale – harmonizimi i legjislacionit, si dhe sigurimin dhe garantimin e pavarësisë së bankës qendrore (pavarësisë funksionale, institucionale dhe personale). Puna dhe aktiviteti i BQE-së dhe ESCB-së janë të definuara në mënyrë shumë koncize me Statutet e ESCB-së dhe BQE-së, ku parashihet pavarësia e plotë e BQE dhe Bankave Qendrore kombëtare.

Euro, si valutë e përbashkët për herë të parë është futur në përdorim në vitin 2002 (në fillim përdorimi i euros nisi në 12 shtete të BE-së), dhe shumë shpejtë u bë simbol dhe sinonim i BE-së. Përdorimi i euros ka po ashtu edhe vlera ekonomike dhe politike. Valuta e përbashkët mundëson rritjen e transparencës së çmimeve, lehtëson në masë të madhe tregtinë ndërkombëtare, ulë në masë të konsiderueshme kostot e transaksioneve, por nga ana tjetër zonën e euros e mbronë nga përhapja e çregullimeve të ndryshme ekonomike dhe financiare që mund të vinë nga jashtë.

Përveç konvergencës monetare të shteteve anëtare të UME, në nivel të BE-së është duke u punuar edhe në aprovimin e rregullave dhe legjislacionit që do të

siguronte një nivel shumë më të lartë të integritit ekonomik, që ka të bëjë me harmonizimin e politikave ekonomike dhe fiskale të shteteve anëtare të BE-së.

Marrëveshja për stabilitet, koordinim dhe menaxhim në Unionin ekonomik dhe monetar (Fiscal Compact), që ka hyrë në fuqi nga viti 2013, duhet që të siguroj një konvergjencë të rëndësishme të politikave fiskale të shteteve anëtare (me përjashtim të Republikës Çeke dhe Britanisë së Madhe), por dhe mbikëqyrjen e përhershme duke mundësuar që nga e njëjta të krijohen mekanizmat korrektues (përmirësues), që do të pamundësonin që në të ardhmën të paraqiten disbalancet fiskale dhe të borxhit publik, por që njëkohësisht edhe do të ndikonin në sanimin e problemeve ekzistuese në disa nga shtetet anëtare të BE-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS NË PROCESIN E PARAANTARËSIMIT NE BE DHE UME

Republika e Kosovës synon në vazhdimësi realizimin e qëllimeve ekonomike dhe monetare dhe për këtë qëllim po ndërmerr aktivitete të pandërprera me qëllim të harmonizimit të politikës monetare dhe atë fiskale me politikat e BE-së.

Situata specifike e Republikës së Kosovës në procesin e përafrimit me BE-në. Kosova është shteti i fundit nga grupi i shteteve të Ballkanit Perëndimor që ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) në vitin 2015, ndërsa e njëjta ka hyrë në fuqi në Prill të vitit 2016. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, Komisioni Evropian duhet t'i hapë bisedimet për negociimin e kaptinave të veçanta që duhet ti plotësoj Republika e Kosovës për të marrë statusin e shtetit kandidat.

Ngecja në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, në rastin e Republikës së Kosovës është evidente dhe në të ardhmen duhet bërë përpjekje sistematike, që hendeku zhvillimor, stabiliteti financiar dhe politikat tjera ekonomike specifike në afatin sa më të shkurtë kohor në mes të Kosovës dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe shteteve anëtare të BE-së të zvogëlohet.

Kaptinat që do të hapen në procesin e negociimit për antarësim në BE (nga përvoja e shteteve të Ballkanit Perëndimor) rezulton se numri i kaptinave që do të hapen për negociim mund të jetë nga 30 deri në 35, ku pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë me problematikën ekonomike, financiare e sociale, ku si kaptina të veçanta janë: politika ekonomike dhe monetare, politika e konkurrencës, shërbimet financiare, bujqësia dhe zhvillimi rural, politikat e transportit, energjetika, politika sociale dhe

punësimi, politika rajonale, mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndeti, marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me botën e jashtme, politika fiskale dhe buxhetore, etj.

Tabela 1: Të dhënat komparative për shtetet anëtare dhe kandidatet të BE-së (Viti 2014)

| SHTETI | SIPERFAQJA në mjëra km ² | POPULLSIA në milion | GDP në miliardë € | GDP per capita në € | GDP per capita (PPS, BE-28 = 100%) |
|-------------------------|--|------------------------|----------------------|------------------------|--|
| BE - 28 shtetet anëtare | 4,324.8 | 508.2 | 13,921 | 27,300 | 100 |
| Belgjika | 30.5 | 11.3 | 402 | 36,000 | 119 |
| Bullgaria | 110.9 | 7.2 | 42 | 5,800 | 45 |
| Çekia | 78.9 | 10.5 | 155 | 14,700 | 82 |
| Danimarka | 43.1 | 5.7 | 257 | 45,600 | 124 |
| Gjermania | 357.1 | 81.2 | 2,904 | 35,200 | 122 |
| Estonia | 45.2 | 1.3 | 20 | 14,800 | 73 |
| Irlanda | 84.4 | 4.6 | 185 | 40,200 | 130 |
| Greqia | 131.9 | 10.8 | 179 | 16,300 | 73 |
| Spanja | 506.0 | 46.4 | 1,058 | 22,800 | 94 |
| Franca | 551.7 | 66.4 | 2,142 | 32,400 | 107 |
| Kroacia | 56.5 | 4.2 | 43 | 10,200 | 61 |
| Italia | 301.3 | 60.8 | 1,616 | 26,600 | 99 |
| Qipro | 9.3 | 0.8 | 18 | 20,500 | 89 |
| Letonia | 64.6 | 2.0 | 24 | 12,100 | 64 |
| Lituania | 65.2 | 2.9 | 36 | 12,400 | 73 |
| Luksemburgu | 2.6 | 0.6 | 48 | 85,300 | 257 |
| Hungaria | 93.0 | 9.8 | 103 | 10,500 | 66 |
| Malta | 0.3 | 0.4 | 8 | 18,600 | 86 |
| Holanda | 41.5 | 16.9 | 655 | 38,900 | 131 |
| Austria | 83.9 | 8.6 | 329 | 38,500 | 128 |

| | | | | | |
|------------------------|-------|------|-------|--------|-----|
| Polonia | 312.7 | 38.0 | 413 | 10,700 | 67 |
| Portugalia | 91.6 | 10.4 | 173 | 16,600 | 79 |
| Rumania | 238.4 | 19.9 | 150 | 7,500 | 55 |
| Slovenia | 20.3 | 2.1 | 37 | 18,100 | 82 |
| Slovakia | 48.8 | 5.4 | 75 | 13,900 | 75 |
| Finlanda | 338.1 | 5.5 | 204 | 37,400 | 113 |
| Suedia | 450.0 | 9.7 | 429 | 44,300 | 127 |
| Britania e Madhe | 244.8 | 64.8 | 2,222 | 34,400 | 109 |
| Mali I Zi | 13.8 | 0.6 | 5 | 5,400 | 40 |
| Maqedonia | 25.3 | 2.1 | 9 | 4,100 | 36 |
| Shqipëria | 28.7 | 2.9 | 10 | 3,400 | 28 |
| Serbia | 88.4 | 7.1 | 33 | 4,600 | 37 |
| Turqia | 783.6 | 77.7 | 601 | 7,800 | 53 |
| Bosnia dhe Hercegovina | 51.1 | 3.8 | 14 | 3,600 | 29 |
| Kosova | 10.9 | 1.8 | 6 | 3,080 | 23 |

Zakonisht, aktivitetet që kanë të bëjnë me politikën ekonomike dhe monetare fokusohen në këto segmente:

- Sigurimi i pavarësisë funksionale, institucionale, financiare dhe personale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK);
- Ndalimi i financimit monetar;
- Ndalimi i financimit preferencial të shtetit nga ana e institucioneve financiare vendore;
- Konsolidimi financiar dhe harmonizimi i politikave dhe metodave të raportimit financiar në krahasim me rregullativën më të re të BE-së që ka të bëjë me konvergjencën e politikave fiskale të shteteve të BE-së, me qëllim që të pamundësohet në të ardhmën që të paraqiten disbalancet e ndryshme makroekonomike;

- Rritja e konkurueshmërisë së ekonomisë kosovare me qëllim që të zvogëlohen disbalanset makroekonomike dhe arrijtjen sa më të shpejtë të qendrueshmërisë makroekonomike.

Në procesin e bisedimeve, Republika e Kosovës do të ketë një tretman të veçantë për shkak të regjimit monetar që e kemi. Për shkak të kushteve dhe rrethanave të veçanta nëpër të cilat ka kaluar Kosova, nga qershori i vitit 1999, dhe me një vendim të veçantë të UNMIK-ut marka gjermane (DM) përdorej si mjet pagese, ndërsa nga viti 2002 euro u bë mjet zyrtar i pagesës, me ç'rast aktivitetet ekonomike janë të bazuara në "eurizimin" si një strategji monetare.

Në kuadër të Bashkimit Evropian nuk është i detyrueshëm harmonizimi i të gjitha llojeve të tatimeve, ndërsa harmonizimi tatimor arrihet përmes koordinimit të sistemeve tatimore të shteteve anëtare të BE-së, me qëllim që të mos ndikohet negativisht në funksionimin e tregut të brendshëm të BE-së. Çdo shtet anëtar i BE-së ka të drejtën që të mbaj sistemin vetanak tatimor, si dhe të aplikojë lloje të tjera të tatimeve, por me kusht që disa pjesë (normën tatimore, bazën tatimore, etj.) t'i harmonizoj me legjislacionin evropian. Të hyrat nga tatimet, si të hyra shtetërore, kanë rëndësi të jashtëzakonshme për vëllimin e buxhetit të shtetit, nga i cili në masë të madhe varet dhe mundësia e realizimit të qëllimeve të ndryshme të politikës ekonomike nga fusha ekonomike dhe e punësimit. Në këto raste shtetet anëtare në mënyrë të pavarur vendosin për çështjet nga fusha e tatimit, me çka edhe ruhet edhe autonomia e tyre nacionale.

Tatimet indirekte – kompetencë e BE-së

Tatimet indirekte janë tatimet që përlllogariten në lidhje me veprimet e prodhimit, konsumimit ose këmbimit të mallrave dhe shërbimeve.

Tatimet indirekte ndërlidhen me Tatimin në Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe akcizat në produktet e duhanit, alkoholit, naftës, e disa mallrave tjera të luksit, që në mënyrë direkte ndikojnë në lëvizjen e lirë të mallrave si dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve. Kjo dhe është arsyeja parësore se pse duhet bërë harmonizimin në nivel të BE-së, pasi që çdo ndryshim ose dallim i theksuar në shkallët e TVSH-së dhe akcizave për disa produkte mund ta prish dhe çregulloj konkurrencën e tregut në nivel të BE-së.

Tatimi në vlerën e shtuar për herë të parë ka filluar të aplikohet në vitin 1970 si një tatim në konsum që zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit dhe distribuimit të mallrave dhe shërbimeve. Norma minimale e TVSH-së në kuadër të BE-së është

15% dhe vlenë për mallrat dhe shërbimet. Në kuadër të BE-së ekzistojnë dhe paraqiten dallime të theksuara në pagesën dhe llogaritjen e TVSH-së, nga shkalla më e ulët prej 15% që paguhet në Luksemburg, Qipro (17%) Malta (18%), Gjermani (19%) e deri në 25% e 27% në Danimarkë e Hungari. Norma e TVSH-së në Republikën e Kosovës, deri në vitin 2015 ishte unike 16%, ndërsa pas reformimit të këtij sistemi përmes amandamentimit të ligjit “Për Tatimin e Vlerës së Shtuar”, duke reduktuar TVSH-në nga 16%, sa ishte për të gjitha mallrat dhe shërbimet në dy shkallë, varësisht nga produkti dhe shërbimi, me ç’rast TVSH prej 8% do të paguhet për shërbimet publike si energjia, uji, mbeturinat, ngrohja dhe pastrimi i rrugëve, si dhe produktet bazë të shportës së konsumatorit: buka, vaji, kripa, sheqeri, qumështi, orizi, vezët, barnat, produktet farmaceutike dhe pajisjet mjekësore, ndërsa TVSH-ja për të gjitha produktet tjera është rritur nga 16% në 18%.

Normat më të ulëta të TVSH-së se ato mesatare janë të lejuara për mallrat dhe shërbimet që nuk janë konkurrese për mallrat dhe shërbimet nga shtetet tjera anëtare, si p.sh. barnat apo mjetet higjienike, etj..

Legjislacioni i BE-së që ka të bëjë me akcizat është i fokusuar në harmonizimin e tyre në tre kategori të produkteve: produktet nga duhani, pijet alkoholike dhe energjentët. Legjislacioni në fuqi përcakton normat minimale të tatimit për çdo lloj të këtyre produkteve. Normat minimale të tatimit për derivate, gazin natyror, energjinë elektrike dhe thëngjillin janë caktuar me qëllim të sigurimit të konkurrencës lojale, por nga ana tjetër shërbejnë dhe si mjet për të stimuluar kursimin e energjisë por dhe përdorimit më të madh të lëndëve djegëse më ekologjike, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mëtejme ekologjike të ambientit jetësor. Shtetet anëtare të BE-së mund të përcaktojnë dhe tatime të tjera të veçanta edhe në disa produkte të caktuara, por me kusht se zbatimi i tyre nuk do të krijoj pengesa të theksuara në lëvizjen e lirë të mallrave jashtë teritorit të shtetit.

Tatimet direkte – në kompetencë të shteteve anëtare

Tatimet direkte janë tatimet që ngarkojnë aftësinë ekonomike të tatimpaguesit, duke e ngarkuar drejtëpërsëdrejti (direkt) pasurinë dhe të ardhurat e tija. Në tatimet direkte bëjnë pjesë: tatimet në të ardhura, tatimet në pronë, tatimet në fitim, tatimet për përdorimin e të mirave, etj..

Pjesën më të madhe të legjislacionit nga kjo fushë, shtetet anëtare e përcaktojnë në mënyrë të pavarur, por duke qenë të obliguara të respektojnë katër liritë themelore

nga Marrveshja për BE-në (lirinë e lëvizjës së personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit).

Legjislacioni i BE-së, në fushën e tatimeve direkte zakonisht ka të bëjë dhe është fokusuar në tatimin në fitim që janë të obliguara ta paguajnë firmat. Në këtë rast qëllimi parësor i BE-së është që të parandalohet konkurrenca e dëmshme tatimore në mes të shteteve anëtare si dhe garantimit të parimit të lëvizjës së lirë të kapitalit në kuadër të BE-së.

Republika e Kosovës gjatë negocimit për antarësim në BE, duhet që të funksionalizoj sistemin e këmbimit të informacioneve për TVSH në mes organeve kompetente, që do të mundësoj që në kuadër të shteteve anëtare përmes rrjetit të përbashkët informativ të këmben të gjitha informacionet në lidhje me TVSH-në, me ç'rast të njejtat mund t'i përdorin shtetet anëtare, administratat tatimore, por dhe tatimpaguesit.

Po ashtu, këmbimi i informacioneve në mes të organeve kompetente të shteteve anëtare duhet të sigurohet edhe për tatimet direkte.

Mbikëqyrja Financiare

Ka të bëjë me aprovimin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare në lidhje me kontrollat e brendshme financiare, standardet e revizionit ekstern si dhe praktikave më të mira të BE-së që kanë të bëjnë me sektorin publik. Sistemi i kontrollave të brendshme financiare ndikon në avancimin e disiplinës dhe transparencës në shfrytëzimin e mjeteve vetanake dhe të atyre të BE-së, si dhe në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Në kuadër të mbikëqyrjes financiare përfshihen katër fusha më të rëndësishme: kontrolli i brendshëm publik financiar (PIFC), revizioni ekstern, mbrojtja e interesave financiare të BE-së, dhe mbrojtja e euros nga falsifikimi.

Kontrolli i brendshëm publik financiar (PIFC)

Koncepti PIFC është zhvilluar nga ana e Komisionit Evropian me qëllim që të i'u ndihmohet shteteve kandidate për pranim në BE në reformën e sistemeve të tyre të kontroleve të brendshme si dhe në menaxhimin e mjeteve vetanake dhe mjeteve të BE-së, duke i përdorur standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë të BE-së.

Kuptimi Kontrolli i brendshëm publik financiar përfshinë një sistem gjithëpërfshirës që zbatohet me qëllim të menaxhimit, kontrollës, revidimit dhe raportimit në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti nacional ose nga mjetet e BE-së. Ky sistem në vete ngërthen: menaxhimin e mirë financiar, kontrollat financiare dhe kontrollat të tjera, që do të mundësojnë zhvillimin e proceseve ekonomike dhe financiare në mënyrë të ligjshme, efikase dhe efektive.

Kontrolli i brendshëm publik financiar në sektorin publik përfshinë:

- Menaxhimin dhe kontrollën financiare;
- Revizionin e brendshëm;
- Njësinë qendrore për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollën dhe revizionin e brendshëm në sektorin publik.

Menaxhimi financiar dhe kontrollat është një sistem i kontrollës së brendshme që përcakton dhe për të cilin përgjegjës është menaxheri i subjektit, që nënkupton vendosjen e një sistemi të menaxhimit me rreziqet si dhe zbatimin e kontrollave financiare. Një sistem i koncipuar në mënyrë të tillë do të sigurojë se në realizimin e qëllimeve të subjektit të caktuar, mjetet buxhetore por dhe ato të tjera do të shfrytëzohen: drejtë, në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Revizioni i brendshëm – paraqet një aktivitet të pavarur, objektiv dhe këshilldhënës, që zbatohet tek subjektet e sektorit publik me qëllim të rritjes së vlerës dhe të avancimit afarizmi i subjektit. Përmes përdorimit të kësaj metodologjie të mbështetur në revizionimin e sistemit, subjekteve ekonomike i mundësohet që më lehtë të realizojnë qëllimet e tyre të parashtruara.

Qëllimi parësor i revizionit të brendshëm është që të identifikohen rreziqet potenciale me të cilat mund të përballen subjektet nga sektori publik, t'i vlerësoj mënyrat e kontrollës, të siguroj që kontrollat e njëjta funksionojnë në mënyrë adekuate si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, por dhe që drejtuesit në kohën e duhur të kenë rekomandime adekuate, me qëllim që të realizohet efikasiteti i proceseve afariste në kuadër të subjektit të caktuar.

Çdo subjekt për t'i realizuar qëllimet e parashtruara në mënyrë sa më efikase, me rëndësi është që të marrë vendime cilësore dhe në kohën e duhur dhe të njejtat nuk mund të realizohen, nëse subjekti nuk disponon informata cilësore. Në këto raste kontrollat e brendshme është ajo që verifikon sistemin e informacionit dhe siguron informacionet më të duhura dhe cilësore për drejtuesin e subjektit, nga të cilat në istancën e fundit varet dhe mbrojtja e interesave të qytetarëve.

Revizioni i jashtëm

Për funksionimin ligjor dhe të suksesshëm të sektorit publik me rëndësi të veçantë është ekzistimi i institucionit të kontrollit të jashtëm, që duhet të jetë profesional dhe i pavarur nga ndikimet politike ose ndikimit të grupeve të caktuara të interesit. Organi i pavarur dhe autonom i revizionit ka për detyrë parësore që të zbatojë revizionin e jashtëm dhe si organ për punën dhe aktivitetet e tija i përgjigjet vetëm Parlamentit. Institucionet qendrore të revizionit bëjnë revizionin (kontrollën) e rregullsisë, ligjshmërisë dhe efikasitetit të menaxhimit të pasurisë publike si dhe detyrimeve, buxheteve dhe të gjitha punëve financiare të subjekteve, burimet e financimit janë publike ose krijohen përmes shrytëzimit të pasurisë shtetërore.

Qëllimi parësor i revizionit është të verifikohet se a janë zbatuar dispozitat ligjore në përdorimin (shfrytëzimin) e mjeteve publike (shtetërore), që të zbulohen parregullsitë në zbatimin e rregullave financiare apo buxhetore, si dhe të verifikohet racionaliteti në një anë, por dhe dobia nga shpenzimi i parasë publike, nga ana tjetër.

Parimet kryesore të revizionit të sektorit publik janë të përcaktuara me ISSAI – Korniza e Standardeve të Revizionit me të vetmin qëllim të unifikimit dhe standardizimit të praktikës së revizionit, zbatimin e procedurave identike si dhe rregullave unike në revizionin e subjekteve shtetërore dhe publike.

Ne Republikën e Kosovës, detyrën e revizionit të jashtëm e ushtron Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) që është themeluar në bazë të Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës. Misioni i këtij institucioni të rëndësishëm është që të "Kontribuojë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike duke kryer auditime cilësore në pajtim me kornizën ligjore dhe standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht si dhe duke aplikuar praktikat më të mira evropiane."

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Me qëllim që të sigurohet mbrojtja financiare e interesave të BE-së, është themeluar Zyra Evropiane për Luftimin e Mashtrimeve (OLAF-European Anti-Fraud Office), qëllimi i së cilës është lufta kundër korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që shkaktojnë pasoja financiare. Denimet për keqpërdorimin e mjeteve financiare nga buxheti nënkuptojnë ndjekjen penale nga ana e organeve të shtetit, procedurat disiplinore, si dhe sanksione administrative dhe financiare.

Në bazë të kërkesës së Komisionit Evropian në të gjitha shtetet anëtare dhe kandidate për BE, është themeluar Shërbimi për Luftimin e Mashtrimeve AFCOS (Anti-Fraud Coordination Service) që ka për detyrë dhe është përgjegjës për parandalimin e të gjitha parregullsive dhe mashtrimeve që mund të bëhen nga shfrytëzimi i mjeteve financiare të BE-së, por dhe ofrimin e mbrojtjes më cilësore dhe efikase të interesave të saja financiare.

AFCOS është i detyruar që OLAF-it të i'a dërgoj të gjitha raportet dhe të dhënat për parregullsitë dhe mashtrimet e zbuluara, si dhe të mirret me procesimin e tyre.

Dispozitat financiare dhe buxhetore

Çdo shtet anëtar i BE-së ka të drejtë që të shfrytëzoj mjetet nga Buxheti i BE-së, por dhe detyrimin që të paguaj mjete të përcaktuara në buxhetin e përbashkët. Mjetet buxhetore të BE-së sigurohen nga tri baza të të ardhurave: mjetet vetanake tradicionale (të hyrat nga doganat, duke i përfshirë dhe doganat për produktet bujqësore); mjeteve vetanake në bazë të tatimit në vlerën e shtuar (TVSH) dhe mjeteve vetanake nga pagesat e shteteve anëtare në bazë të vlerës së GDP-së që e realizon shteti anëtar.

Buxheti vjetor planifikohet në kuadër të perspektivës financiare – kornizës shumëvjeçare financiare, që më tepër ka të bëjë me anën e shpenzimeve, respektivisht programeve që do të financohen nga buxheti i BE-së. Nga mjetet e buxhetit të BE-së financohen aktivitete të ndryshme, duke filluar nga sektori agrar, zhvillimi rajonal, mbrojtja e ambientit jetësor e deri tek mbrojtja e të drejtave të njeriut. Për periudhën 2014-2020 në bazë të kornizës financiare janë paraparë që të ndahen 960 miliardë Euro.

Karakteristikat e programit “Evropa 2020”

Strategjia e re evropiane ka karakter afatshkurtër dhe qëllimi i saj parësor është që të sigurojë një dalje të suksesshme nga kriza e tanishme ekonomike dhe financiare, por që dhe njëkohësisht të sigurojë dhe një zhvillim më të qëndrueshëm dhe hapje më të madhe të vendeve të reja të punës, si dhe kushte më të mira për jetesë. Pikënisja fillestare për hartimin e kësaj Strategjie ishin: plani për daljen nga kriza e tanishme ekonomike dhe financiare; ballafaqimi më i suksesshëm me sfidat globale; kontinuiteti në zbatimin–vazhdimin e Strategjisë së Lisbonës; mbështetja më e fuqishme financiare; koordinimi më i mirë me politikën tjera të BE-së; ndarja më e mirë e punëve në mes të institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare;

mekanizmat e ri për zbatimin e qëllimeve të parashtruara; instrumentet më të fuqishëm të drejtimit ekonomik, si dhe forcimi i konkurrencës në nivelin evropian. Elementet e ndërlidhura të Strategjisë Evropa 2020 janë: tri fusha të ndërlidhura prioritare, pesë qëllime kryesore kuantitative, shtatë iniciativa parësore, dhjetë udhëzime të integruara, kordinimi në mes politikave ekonomike, instrumentet më të fuqishëm për përcjelljen e zbatimit të realizimit të strategjisë, ndarja e qartë e kompetencave dhe relevancave për shtetet që aspirojnë kyçjen në Bashkimin Evropian. Kjo Strategji për dallim nga Marrëveshja e Lisbonës, përmbanë edhe dimensionin ekstern-të jashtëm, që i mungonte asaj të Lisbonës. Marrëveshja e Lisbonës mundësonte paraqitjen e jashtme të BE-së në mënyrë më konsistente dhe më koherente, që nënkuptonte; politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, tregtinë, bashkëpunimin në ndihmat humanitare dhe dimensionet e jashtme të politikave interne, siç janë: energjetika, hulumtimet, arsimi, punësimi, mbrojtja e ambientit jetësor, etj. Strategjia Evropa 2020 nuk është relevante dhe e zbatueshme vetëm në shtetet anëtare të BE-së, por dhe për shtetet candidate dhe ato potenciale për t'u antarësuar në Bashkimin Evropian.

Tri fushat prioritare

Strategjia Evropa 2020 është e fokusuar në tri prioritete të ndërlidhura në mes vete:

1. **Shtimi i mençur** – zhvillimi i ekonomisë të mbështetur në dituri dhe inovacione (hulumtimet shkencorë–teknologjike, inovacionet, arsimimi dhe shoqëria digjitale);
2. **Shtimi i qëndrueshëm** – njëkohësisht stimulon edhe konkurrueshmërinë dhe prodhimtarinë, që në mënyrë më efikase i përdorë resurset ekzistuese; dhe
3. **Shtimi gjithëpërfshirës** – participimi më i mirë në tregun e punës, lufta kundër varfërisë dhe kohezioni social.

Përveç këtyre qëllimeve të parashtruara afatgjate, si qëllim prioritar afat shkurtës i kësaj strategjie është dalja sa më shpejtë nga kriza e tanishme ekonomiko–financiare që e ka kapluar pjesërisht edhe BE-në.

Instrumentet për implementimin e Strategjisë “Evropa 2020”

Për implementimin e çdo strategjie me rëndësi të veçantë është që të zgjedhen instrumentet efikase, kështu që edhe për implementimin e strategjisë Evropa 2020 është përpunuar si një set i ri me gjashtë instrumente të reja, që duhet të ndikojë në realizimin sa më efikas të kësaj strategjie, por dhe realizimin e masave të parapara.

Po ashtu, është e paraparë dhe përcjellja e programeve të reformave në shtetet anëtare si dhe ndarja e qartë e obligimeve në mes të BE-së dhe shteteve anëtare.

Po ashtu, duhet theksuar se të gjitha politikat e BE-së, instrumentet, aktet ligjore si dhe instrumentet financiare do të jenë në funksion të realizimit të qëllimeve të kësaj strategjie. Komisioni Evropian për këtë qëllim është fokusuar në politikat kryesore ekonomike, siç janë: tregu i përbashkët, buxheti, konkurrenca dhe tregtia e jashtme e BE-së.

Institucionet e BE-së e përcjellin realizimin e strategjisë në tri drejtime:

Faktorët makroekonomik – a është ambienti makroekonomik stabil dhe i favorshëm për të arritur shtim më të shpejtë ekonomik dhe rritje të punësimit?

A janë në gjendje që politikat aktuale ekonomike ti zgjidhin disbalancet ekzistuese makroekonomike, si dhe çështjet që janë të ndërlidhura me dimensionet makroekonomike të konkurrueshmërisë? A ekzistojnë efektet *spill-over* (negative dhe pozitive) nga ekonomitë kombëtare, e në veçanti në kuadër të eurozonës?

Reformat për forcimin e shtimit – si reformat strukturale stimulojnë sektorët I&R dhe inovacioneve, shfrytëzimin më efikas të resurseve, ambienti i shëndoshë afarist, punësimi, arsimi dhe kohezioni social?

Financat publike (mbikëqyrja më rigoroze fiskale) në kuadër të Paktit për stabilitet dhe shtim. Çka është bërë dhe arritur në zvogëlimin e borxheve të disa shteteve si dhe deficitit buxhetor (konsolidimi fiskal) në drejtim të financave publike të qëndrueshme? Si janë kufizimet fiskale në zbatimin e politikave shtetërore për rritjen e shtimit ekonomik?

Realizimi i strategjisë Evropa 2020 përcillet përmes këtyre instrumenteve:

Komisioni Evropian në fillim të çdo viti publikon Pasqyrën Vjetore të Shtimit Ekonomik (*Annual Growth Survey*) që përmbanë masat për stabilitetin makroekonomik të shteteve anëtare të eurozonës, me qëllim që t'i baraspeshojnë buxhetet shtetërore dhe që të rrisin shtimin ekonomik.

Një nga argumentet që shkon në favor të integritimit evropian ka të bëjë me efektet e ekonomisë së globalizuar mbi një shtet të caktuar kombëtar. Marrë në përgjithësi, qeveritë e shteteve më të zhvilluara industriale, që kanë teknologji më të avancuara por dhe që dekadave të fundit gjithnjë e më shumë po i përdorin avantazhet e ekonomisë së vëllimit dhe të shkallës, janë të vetëdijshme për faktin se rritja e shpejtë ekonomike ka koston e saj sociale dhe politike, siç janë: shtimi i papunësisë, varfërisë, pabarazisë në të ardhura, rritja e tensioneve sociale e deri tek ndryshimi i strukturës së popullsisë në shtetet e tyre si nga aspekti nacional, fetar e racor. Në qoftë se nuk frenohen, këto efekte në periudhën afatmesme, këto efekte do të shëndërroheshin në shkaqe potenciale të një shpërbërje shoqërore dhe të

destabilizimit të brendshëm të BE-së. Deri më tani disa nga këto efekte janë zgjidhur përmes zbatimit të politikave sociale. Disa nga shtetet në BE, në radhë të parë shtetet sociale i'a kanë dalë që t'i ulin dhe kontrollojnë disa nga këto efekte negative, përmes sistemeve të ndihmës sociale, rregullimit të tregjeve të punës si dhe politikave rishpërndarëse.

Globalizimi gjithnjë e më i shpejtë i ekonomisë dhe tregjeve financiare e ka prishur ekuilibrimin e brishtë në mes rritjes ekonomike dhe ndihmës sociale. Në këto raste, globalizimi ka shfaqur një efekt të dëmshëm duke i lidhur duart qeverive të shteteve kombëtare, pasi që korporatat e mëdha multinacionale mund t'i shmangen lehtësisht ligjeve në fuqi që rregullojnë fushën e tregut të punës, duke u transferuar në vendet ku tregjet janë më pak të rregulluara dhe ku fuqia punëtore është shumë më e lirë. Rreziku i ikjes së kapitaleve i detyron të gjitha qeveritë që t'i mbajnë taksat në nivele të ulëta (në veçanti ato të bizneseve dhe të korporatave).

Politikat ekonomike të BE-së ia kanë dalë disi që përmes shfrytëzimit të subvencioneve dhe politikave të tjera rishpërndarëse të menjanojnë disa nga efektet e dëmshme të konkurrencës rajonale në mes shteteve anëtare. Për më tepër, Gjykata Evropiane e Drejtësisë (*shih më tepër: James Gordon Finlayson: Habermas – një hyrje e shkurtër, Ideart, Tiranë 2005*), ka nxjerrë qindra vendime gjyqësore që kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë në çështjen e drejtësisë sociale duke prekur tërthorazi edhe tregun e brendshëm të përbashkët. Në këtë rast, BE duhet të manovrojë në mes synimeve kontradiktore të punësimit, fuqisë konkurruese dhe rritjes ekonomike, duke ndërmjetësuar marrëveshje në mes nevojave të shteteve të pasura, të cilët janë edhe kontribuesit e vërtetë, dhe vendeve të varfëra anëtare, apo përfituesit e vërtetë.